

88

SYZET ME  
DIOPTRI




**KONTRACEPSIONI**

**FTOHJE E ZAKONSHME APO GRIP**

**NË RITËM ME  
LAURA KËRLIUN**





# S. BOULARDII BULACOL®

*Saccharomyces boulardii* капсула 250/500 mg

Пробиотски квасец кој со својата активност допринесува:

- во зачувувањето на здравјето и функцијата на дигестивниот тракт;
- го ублажува интензитетот и времетраењето на стомачните тегоби како што се (дијареја , надуеност, мачнина, болка во stomакот).



**Hemofarm**  
STADA GRUPA

Пред употреба внимателно да се прочита упатството! За индикациите, ризикот од употреба и несаканите дејства на граничниот производ, консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.



PËRMBAJTJE

SYZET ME  
DIOPTRI

**05.**



MAXHUNI

**08.**



NË RITËM ME  
LAURA KËRLIUN

**10.**



MESVAKTE TË  
SHËNDETSHME

**14.**



FTOHJE E  
ZAKONSHME  
APO GRIP

**16.**



ÇKA ËSHTË  
OKLUZIONI?

**24.**



USHTRIME PËR TRAJTIMIN  
E VËSHTIRËSIVE  
PSIKOLOGJIKE

**26.**



SA JETËSË TË  
SHËNDETSHME BËNI?

**30.**



IMPRESUM

Redaktor kryesor dhe përgjegjës: Master i farmacisë Jovana Uzellaç | Shef i redaksisë: Esin Zekir | Redaktor i fotografsisë: Lençe Naumovska | Redaktor artistik dhe grafik: Lençe Naumovska  
Bashkëpunëtore: Sanja Angelovska | dr. Zorica Martinoska Andonova | Branko Poposki | ass. dr. Iva Malahova | dr. Katerina Nikolovska | dipl. farmacist Gabriela Kaçakoska - Naneska  
Marina Ançevska | Simona Popovska | dr. Slagjana Angeloska | dipl. farmacist Marija Mukaetova | Lektor dhe korrigues: Ivana Koceska | Përkthim: Arditë Zulfu  
Botues: Feniks Farma DOOEL Shkup, rr. "Jadranika magistrala" nr. 31, 1000, Shkup | Redaktim teknik: Idea Lab DE D00 | Marketing: bettymkd@phoenixpharma.com.mk  
Boton: EVROPA 92, rr. Krizovska nr.52, 2300, Kocan | Fotografi: Depositphotos, nëse nuk shkruan ndryshe

Ilustrime: Freepik, nëse nuk shkruan ndryshe | Tirazh: 24.000

Revista BETTY është një revistë falas mujore, e disponueshme për të gjitha banorat që mbështesin BETTY konceptin e marketingut në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Të gjitha përmbytjet dhe reklamat e botuara në revistë janë vetëm nga karakteri informativ dhe në asnjë mënyrë nuk mund të zëvendosojnë vizitë të mjekut ose farmacisit. Feniks Farma D00EL Shkup (në tekstin e mëtejshme Botues) nuk është përgjegjës për përbajtjen e teksteve të botuara, si dhe për përbajtja që në reklamohen në revistë, duke perfshirë edhe gabinet ose mosverprimet e pagujlitta. Me publikimin e reklamave në revistë, personat juridikë që i reklamojnë produkte të tyre, deyrinistë do të respektojnë dispozitat nga Udhëzimi për meryn e reklamimit te ilajave dhe pajisjeve medicinale. Ligi për ilaqet dhe pajiset medicinale, si dhe akte të tjera ligjore, përkatese në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë drejtim, botues i revistës përgjoshjet çdo përgjegjës për dëmet që mund të vijnë nga mosrespektimi i dispozitave të lartpërmendura nga personat juridikë, si dhe për çdo dëmit që vijnë nga përdorimi ose abuzimi i përbajtjes së BETTY revistës, përfshirë përbajtja se BETTY revista përfshirë qellime, pa leje me shkrim të botuesit të revistës. Redaksa e BETTY Revistas nuk ka asnjë detyrim të kthejë në tekstet e marra, fotografët dhe postat interneti.

[www.betty.mk](http://www.betty.mk)

# Edhe nje hap...

**ECJA LUAN NJË ROL TË MADH NË SHËNDETIN TUAJ DHE NDIKON  
POZITIVISHT NË SHUMË PJSË TË TRUPIT**

**Edhe një shëtitje e shkurtër është më e mirë se qëndrimi ulur.**

Ja vetëm disa prej përfitimeve nga ecja e rregullt:

- Ecja e bën zemrën më të fortë, duke e nxitur të pompojë më shumë gjak dhe të rregullojë qarkullimin.
- Forcon kockat tuaja dhe zvogëlon mundësinë e zhvillimit të osteoporozës në moshën e vjetër.
- Ul nivelet e kolesterolit në gjak.
- Ul presionin e lartë të gjakut.
- Ecja ul hormonet e stresit, si adrenalina dhe kortizoli.
- Shpejton metabolizmin tuaj.
- Ecja e shpejtë dhe vrapimi i lehtë kanë një efekt pozitiv në mushkëri dhe ju mundësojnë të merrni frymë më mirë.
- Rrit rezistencën e trupit ndaj sëmundjeve infektive, si ftohjet.
- Ecja rrit nivelin e serotoninës dhe endorfinës në trup, gjë që ju bën të ndiheni më të lumtur.
- Meqenëse rregullon në mënyrë natyrale nivelet e insulinës, ecja ju jep një ndjenjë të ngopjes.
- Ecja e shpeshtë do t'ju bëjë të flini më mirë dhe do të përmirësojë cilësinë e gjumit tuaj.
- Ecja ndikon që të keni lëkurë më të bukur dhe më të shëndetshme.
- Për shkak se ecja e rregullt çliron kimikate natyrore që lehtësojnë dhimbjen, migrena ose dhimbja e kokës do të zvogëlohen.
- Me ndihmën e ecjes mund të kontrolloni më lehtë peshën e trupit.
- Ky aktivitet ju mundeson të mbani nën kontroll peshën tuaj. Për shembull: nëse peshoni 70 kg dhe praktikoni ecje të shpejtë për gjysmë ore, do të digjni afersisht 150 kalori. Me fjalë të tjera, me ecje të rregullt, mund të humbni deri në 3 kilogramë në muaj.
- Meqenëse ecja ka një efekt pozitiv në aftësitë tuaja njoħe, ajo gjithashtu ju mbron nga sëmundje të tilli si demenza, depresioni ose Alzheimer.
- Vrapimi i lehtë rrit numrin e qelizave të kuqe të gjakut dhe i bën enët e gjakut më elastike.
- Mëlcia juaj largon lehtësisht lëndët toksike nga trupi.

Ecja e rregullt vonon plakjen dhe zgjat jetën. Hulumtimet kanë treguar se njerëzit që ecin 20-25 kilometra në javë jetojnë më gjatë se ata që nuk ecin aspak.

Sidoqoftë, nëse keni zgjedhur ecjen si një mënyrë për të humbur peshë, duhet t'i kushtoni vëmendje edhe asaj që hani dhe të kontrolloni sasinë e kalorive që merrni gjatë këtij procesi.

## Mënyra se si ecni është e rëndësishme

Kur ecni, duhet t'i kushtoni vëmendje qëndrimit të trupit. Duhet të ecni drejt, pa u anuar prapa ose përpara, sepse vetëm në këtë mënyrë do të siguroheni që çdo pjesë e trupit tuaj është aktive në masë të barabartë. Pozicioni i duarve është po ashtu i rëndësishëm, sepse ato rrisin forcën tuaj dhe ekilibrojnë lëvizjen e shputave kur ecni, ndërsa lëvizja e kraheve ju lejon të digjni 5-10 kalori shtesë. Duart nuk duhet të shtrëngohen asnjëherë në formë të grushtit, gjë që pengon rrjedhjen e rregullt të gjakut në trup.

*Eksperët thonë: "Qofë edhe 30 minuta ecje çdo ditë është jashtëzakonisht e dobishme për trupin e njeriut. Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomanon që të rriturit të ecin të paktën 2.5 orë në javë."*



# Syzet me dioptri si pjesë përbërëse e jetës së përditshme

Kur ishte hera e fundit që keni bërë një vizitë të syve? Kur ishte hera e fundit që keni dëgjuar se kolegët tuaj, anëtarët e familjes ose miqtë përballen me vështirësi në shikim, por megjithatë e shtynë vizitën tek okulist? Këtë vit, Dita Botërore e Shikimit festohet më 8 tetor dhe synon të inkurajojë njerezit pikërisht për ekzaminime të tillë. Shikimi i turbullt, dhimbjet e shpeshta të kokës dhe lodhja nga leximi janë vetëm disa nga shenjat e shumta që mund të keni një çregullim të syve. Shumica e dëmtimeve të shikimit janë të pranishme në çdo grupmoshë.

Perceptimi vizual tek njerezit ose speciet njerëzore është aftësia për të marrë informacione nga mjedisit përmes shqisave të shikimit.

Jetojmë në një kohë dinamike, të rrëthuar nga shumë përparime teknologjike, të cilat çdo ditë e më tepër gjijnë zbatim në jetën tonë të përditshme. Produktet e atyre përparimeve, ndonëse të domosdoshme, ngërthejnë në vete edhe disa anomali. Për shembull, çdo televizor, kompjuter ose laptop, celular dhe tablet lëshon rrezatim që është i dëmshëm për sytë tanë. Në këtë mes nuk mund të mbeten pa përmendur edhe dritat "LED", të cilat na rrethojnë kudo dhe megjithatë lëshojnë reze të dëmshme.

Shumë shkencëtarë sot e ciliësojnë këtë dukuri si një e keqe e domosdoshme.

Shkurtpamësia, largpamësia dhe astigmatizmi janë çregullime të shkaktuara nga një gabim në përthyerjen e drithës.

Shkurtpamësia ose miopia, e cila është e pranishme te rreth 20 përqind e popullsisë, ndodh kur imazhi krijohet përparrë retinës e jo në të, prandaj objektet e largëta duken të turbullta. Sëmundja shfaqet në masë të barabartë si te burrat ashtu edhe te gratë.

Largpamësia është e kundërtë e shkurtpamësise. Lentet e syve krijojnë imazhe përtëj retinës, prandaj objektet e afërta duken të paqarta. Me kalimin e viteve, aftësia natyrore e syrit për t'u përshtatur dalëngadalë zvogëlohet. Largpamësia paraqitet zakonisht pas moshës 42 ose 45 vjeç.

Astigmatizmi shpesh shoqërohet me largpamësi ose shkurtpamësi. Zakonisht shfaqet gjatë lindjes dhe as nuk përkëqësohen e as nuk përmirësohen me kalimin e viteve. Simptomat e zakonshme të astigmatizmit përfshijnë dhimbje në dhe përreth syve, dhimbje koke dhe vështirësi gjatë vozitjes në errësirë.

Çregullimet e mësipërme janë probleme të cilat mund të zbuten me anë të ndihmesave optike.

Përdorimi i syzeve ose mjeteve ndihmëse të syve është sot më i përhapur se kurrë. Kjo ndodh për shkak të disa faktorëve, si shembujt e mësipërm, anomalitë kongjenitale te njerëzit, dëmtimi i mëvonshëm i shikimit, nevoja për një aksesor të modës për të plotësuar imazhin, si dhe disponueshmëria e madhe e llojeve të ndryshme të kornizave optike dhe llojeve të xhamave.

Dëshirojmë të flasim për atë se cilat lloje të kornizave optike dhe xhamave optikë janë më të mirë për ju dhe nevojat tuaja.

Edhe pse syzet përdoren për të korriguar apo përmirësuar shikimin, nuk mund të shpëfillet fakti që ato përcaktojnë stilin tuaj. Përgjedhja e madhe e kornizave optike përbëhet nga materiale të ndryshme si plastikë, metal (ose një kombinim i të dyave), si dhe një loje të pafund ngjyrash, zbururimesh dhe detajesh.

Zgjedhja e kornizave optike këshillohet të përqendrohet kryesisht te rehatia, sepse përdoruesi nuk duhet të ndihet në siklet kur t'i mbajë ato (p.sh. të ndiejë rëndesë mbi hundë dhe veshë, t'i shtrëngojnë kokën apo krahët e syzeve të mos qëndrojnë siç duhet mbi veshë).

Faktori tjeter që duhet marrë parasysh gjatë blerjes është madhësia e fushës së pamjes (ku është i vendosur xhami optik). Rekomandimi ynë është që në rast të problemit me largpamësinë, personi duhet të zgjedhë korniza që kanë një fushë më të vogël pamjeje. Arsyja për këtë është nevoja e përdorimit të këtyre syzeve vetëm kur personi shikon afer vetes (lexon, përdor telefonin celular ose kompjuterin), d.m.th. jo më larg se gjatësia e krahut të vet dhe kur ndryshon pamjen (p.sh. më larg), personi të jetë në gjendje të shikojë mbi syzet (shikimi nëpërmjet syzeve për afer, në distancë, mund të barazohet me shikimin në distancë përmes xhamit zmadhues).

Kur bëhet fjalë për shkurtpamësinë, rekomandimi ynë është që të kenë fushë më të madhe të pamjes. Rekomandimi vjen për shkak të nevojës që fusha e pamjes të "mbulohet" nga të gjitha anët me xham optik, sepse kur shikohet larg, pamja lëviz në të gjitha anët dhe nën çdo kënd. Shkurtpamësia përfshin një përqindje më të madhe të aktiviteteve të përditshme, si shikimi i televizorit, vozitja, puna në kompjuter dhe çdo aktivitet tjeter që dallon nga shikimi nga afer. Prandaj ne rekomandojmë që rehatia të jetë faktori kryesor gjatë marrjes së vendimit.

Të gjitha rekomandimet e mësipërme vlefjanë edhe për astigmatizmin.

Në këtë mes duhet të përmendim edhe llojet e xhamave (lenteve) optikë, siç janë zgjdhjet 2 në 1 ose 3 në 1 për problemet me shikimin. Xamat bifokal ose 2 në 1 përdoren për shikim në largësi dhe nga afër. Këto syze kanë një "dritare" të dukshme që shërbën si fushë pamjeje për afër. Xamat multifokal ose 3 në 1 janë zgjdhje për të parë në largësi, në një distancë mesatare, si dhe afër. Ndonëse nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm midis këtyre xhamave (lenteve) dhe atyre që përdoren për larg dhe afër, megjithatë ofrojnë kanale vizioni sipas nevojës specifike të përdoruesit.

Xamat multifokal zgjdhin problemin e përdoruesve që përballen me largpamësi dhe shkurtpamësi, ndërsa përdorin vetëm një palë syze.

Përveç komoditetit dhe stilit të kornizave optike, një tjetër faktor po aq i rëndësishëm për zgjedhjen e syzeve janë llojet e xhamave optikë (lenteve). Përkatësisht, xamat optikë (lentet) bëhen zakonisht prej qelqit mineral ose plastikës organike. Përparsia e qelqit mineral është mundësia minimale për t'u gërvishtrur, ndërsa si e metë e tij konsiderohen pesha dhe fakti se ka shumë të ngjarë që të thyhet nëse bien syzet përtokë. Qelqi mineral dikur ishte zgjedhja e vetme për përdoruesit e syzeve. Sot ka lente për syzet të bëra nga plastika organike. Përqindja më e madhe e përdoruesve zgjedhin këtë lloj lente për shkak të peshës së lehtë dhe shtresave mbrojtëse.

Në vendin tonë, lloji më i shitur i lenteve plastike organike janë të ashtuquajturat lente HMC (Hard Multi Coat), të cilat ofrojnë 4 shtresa mbrojtëse (vështirë për t'u gërvishtrur, kthjellim i shpejtë në ndryshim temperaturash, mbrojtje themelore nga rrezet teknologjike si dhe zvogëlim të efektit të dritave gjatë vozítjes natën), por edhe një çimim më të kapshëm. Kohët e fundit, përzgjedhja e lenteve plastike organike është zgjeruar edhe me mbrojtjen nga rrezet "blu-violet" (zvogëlim i efekteve të dëmshme të rrezeve të emetuara nga pajisjet elektronike dhe dritat LED) me filtrin e njohur gjérësish si "Blue Light Filter". Ky lloj i mbrojtjes është zgjedhja e parë e përdoruesve të syzeve që përdorin intensivisht kompjuterin (më shumë se 4 orë në ditë).



Duhet të theksohet se ekzistojnë edhe xama optikë (lente) pa dioptri, me mundësi për të përbajtur shtresa mbrojtëse. Këta më së shpeshti përdoren nga njerëzit që duan të mbrojnë sytë nga rrezet e dëmshme. Numri i prindërvës që zgjedhin të blejnë syze pa dioptri për fëmijët e tyre sa vjen e shtohet dhe kjo për shkak të kohës në rritje që fëmijët e kalojnë para kompjuterit, tabletit dhe telefonit. Kësisoj mënjanohet deri diku një nga faktorët për dëmtim të hershëm të shikimit.

*syzabërës - optometrist  
Sanja Angelovska  
OPTIKA PRIZMA*

# Цитикол Б®

ЦИТИКОЛ Б  
Е СТЕРИЛЕН  
ОФТАЛМОЛОШКИ  
РАСТВОР СО  
ИНТЕНЗИВНО РОЗОВА  
БОЈА, СПАКУВАН ВО  
ШИШЕ ОД 10 ml

КАПКИТЕ ЗА ОЧИ  
ЦИТИКОЛ Б МОЖЕ ДА  
СЕ УПОТРЕБУВААТ КАЈ  
ПАЦИЕНТИ СО  
ГЛАУКОМ И СО  
ДИЈАБЕТИЧНА  
РЕТИНОПАТИЈА

АЛКАЛОИД  
СКОПЈЕ  
*Здравјешто џрејс се*  
[www.alkaloid.com.mk](http://www.alkaloid.com.mk)

CE 0546



Пред употреба внимателно да се прочита упатството. За индикациите, ризикот од употребата и за несаканите дејства на медицинското средство консултирајте се со Вашиот лекар или со фармацевт.

# MAXHUNI

## një ilaç natyral nga Tikveshi



I mirënjojur nga paraardhësit tanë përfektet e tij të dobishme në shëndetin e njeriut, maxhuni ose i quajtur ndryshe malt rrushi, është lëng rrushi i përqendruar, ilaç natyral dhe pije energjetike me një shije dhe aromë origjinale të ëmbël në të thartë.

Maxhuni përmban një strukturë të tillë të sheqernave që është identike me mjaltin e bletës

Rritja e hardhive të rrushit ka një traditë prej më shumë se 2,000 vjetësh, po aq e vjetër sa edhe historia e rrushit dhe maxhunit. Në të kaluarën, paraardhësit tanë nuk kishin sheqer me shumicë sepse ishte mjaft i shtrenjtë, kështu që përgatisnin ëmbëlsira me maxhun. Fakti që ata i ushqen edhe foshnjat me maxhun është dëshmi përbesimin që kishin në vetitë e tij shëruiese. Sot, shkenca tregon se kjo mënyrë e të ushqyerit është jashtëzakonisht e shëndetshme. Në mesin e njohësve të maxhunit, është e përhapur thënja se maxhuni i rrushit të bardhë është ushqim, kurse ai i rrushit të kuq është ilaç.

Maxhuni fitohet duke zier lëngun e rrushit të shtrydhur nga rrushi i bluar. Për 1 kg maxhun nevojiten rreth 6 kg rrush. Lëngu i marrë shtrydhet me ndihmën e garzës dhe zihet derisa të marrë dendësinë e mjaltit. Pasi të ftohen, futet në kavanoz ose shishe të sterilizuar.

Përmban antioksidantin natyror resveratrol, i cili bën pjesë në grupin e polifenoleve, gjendet në lëkurën e rrushit të zi,



boronicave dhe mjedrave dhe është përgjegjës përmbrrojtjen e enëve të gjakut dhe ruajtjen e elasticitetit të tyre. Maxhuni përmban një strukturë të tillë të sheqernave që është identike me mjaltin e bletës, nga të cilat 50% glukozë (sheqer rrushi) dhe 50% fruktozë (sheqer frutash), është e pasur me vitamina të tretshme në ujë (B1, B2, B6 dhe C), minerale (K, Na, Ca, P, Fe), tanine, flavonoide dhe acide organike (tartarik, malik, limoni).

Rekomandohet për forcimin e sistemit imunitar tek fëmijët, personat në rikuperim, të moshuarit dhe atletët. Ndihmon kundër ftohjeve dhe infeksioneve të sistemit të frymëmarrjes, kapsllékut, anemisë, sëmundjeve të sistemit kardiovaskular dhe rekomandohet veçanërisht për njérëzit me funksion të dëmtuar të mëlcisë për shkak të verdhëzës, alkoolizmit, cirrozës dhe përdorimit të tepruar të barnave.

### Përdorimi përritje të imunitetit:

Fëmijët mbi 1 vjeç - 1 lugë çaji në ushqim, çaj ose ujë çdo ditë

Të rriturit - 1 lugë gjelle në ushqim, çaj ose ujë dy herë në ditë Mund të përdoret në dietën e përditshme përritje të ëmbëlsuar çajin, qumështin, mueslin ose si krem përritje të ëmbëlsira dhe pasta.

Maxhuni ka afat të pakufizuar të përdorimit. Për shkak të pranisë së sheqerit natyror që kristalizohet shpejt, maxhuni mund të marrë konsistencë të trashë, por nëse futet në një tas me ujë të nxehë, ai kthehet shpejt në gjendjen e tij origjinale.

Recetë tradicionale përritje të ëmbëlsuar (byrek i ëmbëlsuar) me maxhun Përzieni 300 g sheqer dhe 300 ml ujë në nxehësi të ulët derisa të shkrihet, shtoni 150 ml vaj, 300 ml maxhun, 800 g miell, 1/2 pluhur pjekjeje, 1 lugë çaji sodë buke dhe 200 g arra të copëtuara. Piqeni në një tigan të lyer me vaj dhe të spërkatur me miell.

# BioGaia™

## Lactobacillus reuteri Protectis Пробиотски капки



БиоГаја ПроТектис капки е граничен производ што содржи Lactobacillus reuteri Protectis кој помага во возобновување на природниот баланс во цревата и одржување на истиот.

Се користат како безбеден и докажан пробиотик кај деца вклучувајќи ги новороденчињата како и прематурните новородени деца.

Капките се користат за:

- Одржување на нормалниот цревен микробиот посебно кај децата родени со Џарски рез
- Инфантилни колики(грчеви), регургитации, констипација, функционална абдоминална болка
- Го намалуваат ризикот од појава на некротизирачки ентероколитис

- Дополнителна терапија на антибиотското лекување
- Подобрување на имунитетот
- Спречување на појава на егзема
- Го намалуваат присуството на helicobacter pylori




# Laura Kërliu

E suksesshme dhe ambicioze, ajo lë gjurmë të thella me ndikimin e saj, ndonëse ende shumë e re dhe me një të ardhme të ndritur përpala vetes.

Bisedojmë me Laura Kërliun, këngëtarë dhe instruktore vallëzimi, vajzë me shumë detyra dhe shumë talent, e cila dëshiron të arrijë sukses për sa kohë që ka një buzëqeshje në fytyrë.





E DASHUR LAURA, QË E VOGËL KE MARRË PJESE NË DISA FESTIVALE NË KARRIERËN TËNDE, SA VJEÇE ISHE KUR ZBULOVE PASIONIN DHE TALENTIN PËR MUZIKËN?

Babai im gjithmonë thoshte: ke ditur të këndosh para se të filloje të flisje. Them se ka të bëjë me gjenet; është një dhuratë nga Zoti dhe besoj se kam lindur për të kënduar. Shfaqjet e mia të para ishin para mysafrëve që na vinin në shtëpi, të cilët habiteshin se si mund të gjeja gjithmonë frysëzim për të kënduar. Pas performancës së parë zyrtare në moshën 7 vjeç, e cila ishte në një festival për fëmijë, isha e bindur se kam lindur për të qenë në skenë.

PËRVEÇ KËNDIMIT, MERRESH EDHE ME VALLËZIM. NA TREGO PAK MË SHUMË RRETH SUKSESEVE TË TUA NË FUSHËN E VALLËZIMIT?

Mund të tingellojë shumë e njëanshme kur flas për këtë dhe njerëzve shpesh u vjen çudi, por e them me plot bindje se vallëzimi ma ka ndryshuar jetën. Në një lokal me muzikë latine në Shkup, krejt papritur një djalë më ftoi që të vallëzonim, ftesë të cilën e refuzova me fjalët se nuk dija të vallëzoja. Për fat të mirë ai ishte këmbëngulës, duke më bërë të ndiqja hapat e tij dhe tëkuptoja se sa mirë ndihem kur vallëzoj. Fillova duke vizituar disa shkolla vallëzimi, pastaj pata mundësinë të udhëtoj dhe të mësoj vallëzimin nga instrukturët më të mirë nëpër vendet e tjera. Tani vallëzimi është dashuria ime e dytë dhe mund të them me kënaqësi se jam bërë edhe instruktore.



## SolDevit<sup>®</sup> 3 1000

Витамин Д<sub>3</sub> (холекалциферол)

Содржи витамин Д<sub>3</sub> кој придонесува за:


- нормално одржување на коски и заби
- нормална функција на мускулите
- нормална функција на имунолошкиот систем



ЛЕСНО ДО СВОЈАТА  
ДНЕВНА ДОЗА на Витамин Д |

PHARMANOVA

Пред употреба внимателно да се прочита упатството. За индикациите, ризикот од употреба и несаканите дејства на лекот консултирајте се со вашиот лекар или фармацевт.



JE VETËM 28 VJEÇE, POR KE KORRUR MJAFT SUKSESE NË KARRIERËN MUZIKORE. CILI ËSHTË SEKRETI I SUKSESIT TËND?

Meqenëse e konsideroj veten një person që gjithmonë përpinqet për më shumë dhe më mirë, mendoj se akoma nuk kam prekur majat. Besoj se më në fund kam gjetur stilin e muzikës që më përshtatet më shumë, ndaj mund të them se jam në rrugën e duhur në kërkim të më të mirës. Të gjitha projektet e mia të ardhshme do të lidhen me dashurinë e fortë që ndiej përvallëzimin dhe muzikën. Këto projekte përfshijnë shumë bashkëpunime të sukseshme me artistë ndërkombëtarë dhe publiku do të ketë mundësinë që t'i shohë dhe dëgjojë në të ardhmen e afërt. Ju premtoj se do të tejkaloj pritshmëritë e publikut. Mbështetur edhe të vërvetas.

### CILI ËSHTË FRYMËZIMI YT PËR JETËN?

Frymëzimi im për jetën është dashuria, ndaj jetës dhe të gjitha detajeve që janë pjesë e kësaj bote. Jetojmë vetëm një herë. Është mirë të gjejmë një mënyrë dhe të shohim gjithmonë anën e bukur të gjëra, sepse gjithësia gjen çdoherë një mënyrë për të na thënë se asgjë nuk është e rastësishme.

A KA DIÇKA QË MUND TË TË DEKURAOJË, POR QË KE NJË MËNYRË PËR TA KAPËRCYER DHE PËR TË ECUR PËRPARA?

Secili prej nesh ka dobësitë e veta, por unë mund të dekurajohem vetëm nga humbja e dëshirës për të përmbrushur ëndrrat dhe qëllimet e mia.

ÇFARË ËSHTË E RËNDËSISHME TË KETË NJË PERSON QË DËSHIRON TË JETË PJESË E JETËS PUBLIKE?

Ëndrrat. Gjëja më e rëndësishme është të zbulosh ëndrrat e tua, t'i mbrosh ato, të luftosh për ta dhe të punosh shumë për t'i vënë në jetë. Jo vetëm për jetën publike, por edhe përlumturinë vetjake, duhet të dimë të dallojmë se në çfarë jemi më të mirët dhe çfarë bëjmë me lehtësi dhe dashuri të madhe. Ndonjëherë mund të jemi shumë të talentuar për një drejtim të caktuar, por nëse nuk punojmë sa duhet, është e vështirë të arrijmë rezultate të larta.

### SI KUJDESESH PËR SHËNDETIN?

Nuk thuhet rastësisht: ti je ajo qe ha. Mu për këtë arsy, për


mua është tejet e rëndësishme të ushqehem shëndetshëm dhe të bëj një mënyrë jetese të shëndetshme. Vetëm në trup të shëndoshë mund të kemi shpirt të shëndoshë. Dua të kujdesem për vlerat ushqyese të ushqimit që ha, ndaj mundohem të zgjedh me kujdes të gjitha gjërat që i konsumoj për çdo ditë. Të afërmit e mi e dinë që më pëlqen të hulumtoj dhe të lexoj më shumë rreth ushqimit dhe ndodh shpesh që të këshillohen me mua në këtë temë.

## A KE REGJIM TË POSAÇËM TË USHQIMIT QË TË RRIT IMUNITETIN DHE SHËNDETIN?

Po, me vite kam një rutinë të caktuar të cilës, përveç ditëve kur jam diku me pushime dhe dua të provoj gjëra të reja, përpinqem që t'i përbahem. Menjëherë pasi zgjohem, praktikoj të pi 2 gata ujë dhe besoj se kjo është mënyra më e mirë për ta zgjuar trupin. Në orën e parë pasi të zgjohem, ha mëngjes, të cilin e shoqeroj gjithmonë me çaj për t'u mbushur me energji. Teoria që mbështes është se një dietë e shëndetshme kërkon të hash shpesh dhe pak. Unë zakonisht ha një vakt të bollshëm dhe katër deri në pesë meze të lehta në ditë. Parapëlqej që një nga mezet e lehta të përbajë përherë fruta.

## SA E RËNDËSISHME ËSHTË QË NJË I RI TË MBAJË SHËNDETIN E VET MENDOR DHE FIZIK TË SINKRONIZUAR?

Sinkronizimi i shëndetit mendor dhe atij fizik është me rëndësi të madhe, jo vetëm për të rinjtë, por për të gjitha grupmoshat. Do të përsëris se këto janë gjëra që e plotësojnë njëra-tjetrën. Me fjalë të tjera, pa shëndet mendor, nuk ka shëndet fizik dhe anasjelltas.



## CILI ËSHTË MESAZHI YT PËR LEXUESIT E REVISTËS BETTY?

Ka shumë mesazhe fryshtuese që më kujtohen çdo ditë, por për mua më e rëndësishmja është: gjej paqen tënde të brendshme! Nëse ia dalim të gjejmë paqen e brendshme, atëherë nuk ka asgjë me të cilën nuk mund të përballemi. Nuk po them që është e lehtë, por është vërtet me rëndësi.

**SYNEVIT**  
www.synev.it.net 02 3225 843

**FERROFECT**  
За нормално формирање на хемоглобин и црвени крвни клетки

-Органски хелиран железен бисглицинат во комплекс со Витамин Ц, Б6, Б12, Фолна киселина, Цинк, Бакар и Манган  
-Висока искористивост (90,9 %)  
-Без гастроични тегоби  
-Без метален вкус

**VOLURINE**  
D-Mannose Complex

-Брза елиминација на Escherichia Coli од уринарниот тракт  
-Синергистички ефект на Д-Манозата, екстрактот од брусница и Витаминот Ц  
-Безбеден за долго и превентивно користење и ефикасно одложување на повторувачки инфекции



## MESVAKTE TË SHËNDETSHME,

## SHPREHI E SHËNDETSHME

Nëse synojmë të përqendrohem i ushqimi i shëndetshëm, ushqimi që nuk përban nivele të larta të yndyrës, kripës, sheqerit, atëherë të gjitha mesvaktet me ushqime të përpunuara nuk duhet të janë në menynë tonë ose duhet ta zvogëlojmë ngrënien e tyre, përkatesisht të përfshihen si përjashtime të rralla. Shmangja e këtyre mesvakteve do të na ndihmojë në synimin tonë për të humbur peshë ose për të mbajtur një peshë normale të trupit.



Mesvaktet gjatë ditës, ushqimet e lehta gjatë shikimit të një serie, filmi ose ndeshje sportive, jo domosdoshmërisht duhet të jetë një shprehi e pashëndetshme që do të na bëjë të shtojmë në peshë dhe do të na shkaktojë probleme shëndetësore shtesë, si niveli i lartë i sheqerit, yndyrnave apo triglicerideve në gjak. Prandaj, në vazhdimin e këtij teksti, unë do t'ju zbuloj disa receta të shëndetshme për përgatitjen e të ashtuquajturave "mesvakte të shëndetshme" që do të bëhen pjesë e shprehive tuaja të shëndetshme. Këto mesvakte do të zvogëlojnë ndjenjën e urisë, do të na mbajnë të ngopur dhe do të na ndihmojnë tërthorazi në procesin e humbjes së peshës. Në përbërjen e tyre ato përbajnjë përbërës që, përvçëse janë të dobishëm për humbje në peshë ose për mirëmbajtje të peshës së trupit, ndihmojnë gjithashtu në forcimin e imunititetit dhe gjallërinë e trupit.

Këto "mesvakte të shëndetshme" zakonisht përbajnjë produkte me drithëra të plota, të pasura me fibra, yndryra dhe sheqerna të shëndetshëm dhe një kombinim të frutave të freskëta.

## SHKOPINJ INTEGRALË ME QIMNON DHE FARÀ LIRI

### Përberësit e nevojshëm:

300 gram miell integral  
250 gram miell të bardhë  
1 qese pluhur për pjekje  
200 mililitra ujë të gazuar ose birrë  
1/4 filxhan vaj  
100 gram luledielli të qeruar  
100 gram farà liri  
50 gram qimnon  
100 gram susam të bardhë dhe të zi  
kripë sipas shijes



### Mënyra e përgatitjes:

Në një tas të thelli, shtoni të gjithë përbërësit, përvèç farave të susamit të bardhë dhe të zi. Përzi me një lugë druri. Kur t'i keni përzier të gjithë përbërësit, filloni të ngjeshni një brumë të butë me duar të pastrë. Nëse gjatë përgatitjes brumi ngjitet në duar, shtoni miell sipas nevojës, derisa të krijohet një masë homogjene. Pasi të keni gatuar brumin, lëreni për rreth 30 minuta dhe më pas formoni shkopinj. Në një tepsi, të veshur më parë me leter për pjekje, rregulloni shkopinjtë e brumit dhe spërkatni sipër farat e susamit të bardhë dhe të zi. Piqni për 20 minuta në një furrë të nxehur paraprakisht në 180 gradë.

Për më tepë, mbi shkopinjtë integralë mund të shtoni fara kungulli ose luledielli, rozmarinë të freskët dhe kripë deti.

## GRANOLA BAR ME ARONIA DHE BAJAME

### Përberësit e nevojshëm:

10 hurma  
100 gram gjalpë bajamesh dhe kokosi ose gjalpë nga ndonjë arrë tjeter  
80 mililitra vaj kokosi  
200 grame tershëre  
1 lugë gjelle fara liri  
1/2 lugë çaji kanellë  
50 gram bajame të pëggjysmuara  
50 gram aronia të freskëta  
1 lugë gjelle luledielli të qeruar



### Mënyra e përgatitjes:

Lërimi humrat në ujë të ftohtë për 8 orë për t'u zbutur, duke hequr kockën prej tyre, ose rrëth 5-10 minuta në ujë të valuar. Pastaj, në blender, shtoni humrat dhe ujin në të cilin kanë qëndruar dhe përzijkeni derisa të bëhet pure.

Vendosni purenë në një tas në zjarr, shtoni gjalpin e arrave dhe vajin e kokosit dhe përzijkeni derisa të fitoni masë homogene.

Në një enë tjeter, shtoni tershëren, lulediellin e qeruar, farat e lirit, gjysmën e aronieve të freskëta, kanellën dhe gjysmën e bajameve të pëggjysmuara. Përzieni të gjithë këtë përzierge në masën e përgatitur

më parë. Që përbërësit të mos ngjiten në duar, rekomandohet të përzini me një lugë druri. Pasi të keni përzier të gjithë masën, vëreni në një tepsi të veshur me leter, shtypeni mirë dhe rrafshojeni nga të gjitha anët, në mënyrë që të mos ketë ajer.

Shtoni pjesën tjeter të bajameve dhe aronive të freskëta në përzierjen e përgatitur, dhe lëreni në frigorifer përrreth 1 deni në 2 orë.

*Kënaquni me shijen e shëndetshme të këtyre dy recetave. Kombinojini ato me lëng portokalli dhe limoni të shtrydhur rishtazi ose çaj boronice të ftohtë dhe gjethë të freskëta nenexhiku.*



bloger - e ushqimi, Branko Poposki

ИТОФАРМ

# ЛИХЕН ФОРТЕ

Моќта на трите лишаи  
против кашлицата!

Лихен Форте сирупот е наменет за:

- Сува и надразнувачка кашлица,
- Воспаленија на горните дишни патишта,
- Сувост и надразнетост на усната празнина и грлото,
- Зарипнатост и болно грло.



Производот може да го употребуваат лица со дијабетес.



СИРУП ОД  
ИСЛАНДСКИ ЛИШАЈ,  
ШУМСКИ ЛИШАЈ,  
БЕЛОДРОБЕН ЛИШАЈ



## FTOHJE E ZAKONSHME APO GRIP, CILI ËSHTË DALLIMI?

humor, të qajnë shpesh dhe të ndjehen të rraskapitur. Sekrecionet e hundës e vështirësojnë marrjen e frysës, ndërsa te më të vegjlit, edhe të ushqyerit.

### SIMPOMAT E GRIPIT

Forma më e rëndë e ftohjes së zakonshme shpesh quhet grip, ndonëse këto janë dy gjendje të ndryshme. Simptomat e gripit fillojnë papritmas, me temperaturë të lartë të trupit, ethe, dhimbje koke, dhimbje të muskujve, plogështi të përgjithshme dhe rraskapitje, përkatësisht ato janë dukshëm më të rënda, më të theksuara dhe më të gjata në krahasim me ftohjen e zakonshme.

### SHENJAT E FTOHJES TE FOSHNJAT DHE FËMIJËT

Te të porsalindurit dhe foshnjat e gjirit, simptomat e ngjashme me ftohjen e zakonshme mund të janë shenje e një sëmundjeje të rëndë, e cila kërkon ekzaminim mjekësor. Te foshnjat më të mëdha dhe fëmijët, shenjat që tregojnë një sëmundje më serioze ose zhvillimin e ndërlikimeve që kërkojnë vëmendje mjekësore janë: kollë e fortë dhe irrituese, frysëmarrje e shpejtë ose e rënduar, zgjerimi i tepert i vrimave të hundës gjatë thithjes së ajrit, dhimbje veshi, refuzim i lëngjeve, përkeqësim i dukshëm i gjendjes së përgjithshme.

Sëmundjet e sistemit të frysëmarrjes, si ftohja dhe gripi janë shkaqet më të zakonshme për vizitë te mjeku, por edhe për mungesa të panumërt nga shkolla apo puna. Si mund ta kuptojmë nëse bëhet fjalë për ftohje të zakonshme ose grip? Ftohja e zakonshme është një infeksion afatshkurtër, i lehtë ose mesatarisht i rëndë në traktin e sipërm të frysëmarrjes. Shkaqet e sëmundjes mund të jenë më shumë se dyqind lloje të ndryshme të viruseve (rinoviruset, adenoviruset, reoviruset, koksaki, parainfluenza etj.)

Me ardhjen e ditëve të para të ftohta në vjeshtë, fillon edhe sezoni i ftohjeve, infeksione ndaj të cilave foshnjat dhe fëmijët e vegjël janë veçanërisht të ndjeshëm. Ftohjet e shpeshta në moshë të hershme ndodhin për shkak të imunititetit ende të pazhvilluar, përkatësisht rezistencës së zvogëluar ndaj shkaqeve të sëmundjes.

### SI TRANSMETOHET INFEKSIONI?

Transmetimi i infeksionit ndodh përmes stërkalave, si p.sh. gjatë teshtitjes dhe kollitjes, por edhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me sendet e përdorura nga personi i infektuar. Ajri i thatë në dhoma të nxeha dhe të paajrosura dëmtón mukozën e frysëmarrjes, zvogëlon aftësinë natyrore të mbrojtjes dhe e bën atë të ndjeshëm ndaj infeksioneve.

### SIMPOMAT E FTOHJES SË ZAKONSHME

Simptomat e ftohjes së zakonshme zhvillohen ngadalë, gjatë disa ditëve. Sëmundja fillon me zënien e hundës, rrjedhje të një sekrecioni të tejdukshëm nga hunda, teshtitje, kollë të thatë të kohëpaskohshme, zjarrmi. Foshnjat ose vogëlushët mund të janë pa

### TERAPIA

Nuk ka barna të veçanta për ftohjen e zakonshme. Në terapinë simptomatike bëjnë pjesë:





- pushimi
- marrja e mjaftueshme e lëngjeve
- dushi me ujë të vakët për ftohje të trupit
- ajrosja dhe lagështimi i ambienteve ku qëndron fëmija

Barnat që përdoren zakonisht për ftohjen e zakonshme janë:

- ilaçë për ulje të temperaturës së trupit
- tretësirë sterile kripërash në formë të pikave të hundës
- më rrallë, te fëmijët parashkollorë, përdorim afatshkurtër i pikave dekongjesteve të hundës
- terapi me vitamina, kryesisht vitaminë C

#### PARANDALIMI

Ndihma më e madhe në parandalimin e përhapjes së infeksioneve virale është zbatimi i masave të përgjithshme parandaluese higjieno-dietike për mbrojtje nga infeksionet dhe forcim të imunitetit:

- shëmangia e kontaktit me personat e infektuar
- larja e duarve si mënyra më e thjeshtë dhe më efektive për të parandaluar infekzionet
- krijiimi i zakoneve të mira higjenike që në moshë të vogël
- përdorimi i faculetave për një përdorim gjatë teshtitjes dhe kollitjes
- mirëmbajtja e higjenës në shtëpi
- mospirja e duhanit në ambiente të mbyllura
- shëmangia e qëndrimit të zgjatur brenda
- ajrosja e rregullt e dhomave
- qëndrimi në ajër të pastër
- shëmangia e ajrit të ndotur
- ushqimi i duhu - ushqyerja me gji deri në muajin e 6-të, kurse më pas, duke vazhduar me ushqyerjen me gji, zbatimi i një diete të pasur me vitamina dhe minerale

#### ANTIBIOTIKËT JANË TË PAFUQISHËM

Antibiotikët janë të pafuqishëm, joefektivë kundër sëmundjeve virale dhe nuk duhet të përdoren. Përdorimi i tyre "për çdo rast" është i paarsyeshëm, nuk do të parandalojë shfaqjen e superinfektionit bakterial dhe çon në zhvillimin e shtameve rezistente të baktereve.



Zorica Martinoska Andonova  
doktoreshë e mjekësisë  
IPSH CITUS, SHTP

## ИМУНИТЕТОТ е приоритет

PROTECT

# IMUNOBETA

$\beta$  - glukan сируп и капсули

- ✓ За зајакнување на имунитетот
- ✓ Како помош кај вирусни, бактериски и габични инфекции
- ✓ Кај зголемен стрес, замор и исцрпеност
- ✓ За деца и возрасни



esensa  
[www.esensa.rs](http://www.esensa.rs)



Пред употреба, внимателно да се прочита упатството! За индикациите, ризикот од употреба и несаканите дејства на граничниот производ, консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.

SEPTIMA  
Христо Татарчев 13 бр.9 Скопје  
тел: 02/3060-175



KËTË MUAJ, DALLOJMË

%



LIVSANE Kalcium  
me aromë limoni  
40 tableta  
shkumëzuese



Livsane Lactoactive Daily  
Immune  
20 kapsula



ACC DIREKT 600 mg  
10 qese



Perluksan  
30 kapsula të buta  
xhelatinë



Immun Action  
60 kapsula




**SNUP® 0,1**  
Sprej për hundë  
10 ml



**SNUP® 0,05%**  
Sprej për hundë  
10 ml



**DuoPack**  
Femibion për  
gratë  
shtatzëna 1  
2 pako



**Herbion®**  
pastila  
prej dredhke  
16 pastila



**Herbion®**  
shurup prej  
likenit  
islandez  
150 ml



**Herbion® shurup**  
dredhkë  
150 ml



**Utiemanoz®**  
Direkt  
10 qese



**Neutrogena Hydro**  
Boost Krem dite për  
ftytyren  
50 ml



**Neutrogena**  
Hydro Boost  
ujë micellar  
për ftytyrën  
400 ml



**Neutrogena**  
Hydro Boost  
xhel ujor  
për ftytyrën  
50 ml



**Doctor's Maxhuni**  
nga rrushi  
340 g



**Doctor's Maxhuni**  
nga hurmash  
340 g

**Doctor's Maxhuni**  
nga manash të zi  
340 g

Para përdorimit, Ju lutemi lexoni udhëzimet e paketimit me kujdes.  
Për më shumë informacion kontaktoni mijekun ose farmacistin tuaj.

# KONTRACEPSIONI

Termi kontrpcion nënkupton metodat e ndryshme që praktikohen me qëllim të mbrojtjes nga shtatzënia e padëshiruar.

Efektiviteti i kontracionit varet nga metoda e zgjedhur e kontracionit, por edhe nga përdorimi i drejtë i saj. Prandaj shkalla e suksesit varet nga përdorimi i drejtë dhe/ose adekuat i metodës kontrceptive dhe zakonisht është e ndryshueshme. Nuk ka një metodë të përsosur për mbrojtje nga shtatzënia e padëshiruar, sepse secila prej tyre ka të mirat dhe të këqijat e veta.

Sot ekzistojnë shumë lloje të kontracionit, edhe atë: kontracioni hormonal, intrauterin, mekanik ose kimik, metoda natyrale e kontracionit dhe sterilizimi.

**KONTRACEPSIONI HORMONAL** siguron mbrojtje të thjeshtë dhe të sigurt, por përdoret gjithmonë në konsultim me gjinekologun. Vepron në mënyrë sistematike, që bazohet në efektet e hormoneve që përbahen: estrogjen dhe progestin. Këto hormone frenojnë hormonet natyrore ciklike në trupin e gruas, me qëllim të parandalimit të shtatzënisë. Ato parandalojnë ovulacionin, trashin mukozën rreth qafës së mitrës, duke e bërë më të vështirë migrimin e spermës në drejtim të qelizës vezës dhe zvogëlojnë pranueshmérinë e endometriumit për qelizën vezë të fekonduar.

Është i disponueshëm në forma të ndryshme si pilula hormonale ose të ashtuquajturat pilula anti-bebe, kontraktivë të injektuar, imante nënlekurore, unaza vajinale dhe fasha transdermale.

Më të përdorura janë pilulat hormonale, edhe atë në kombinim me kontraktivët oralë, të cilët janë një kombinim i hormoneve estrogjen dhe progeseron. Sot, shumica e pilulave kontrceptive kanë 28 pilula, nga të cilat 21 janë pilula që aktivizojnë hormonet dhe 7 pilula placebo, në mënyrë që të mos humbet ritmi i përditshëm i marrjes së pilulave. Marrja e tabletave placebo rezulton në gjakderdhje (e ngjashme me gjakderdhjen menstruale). Megjithëse mund ta mermi tabletën në çdo kohë brenda dites, është më mirë ta mermi para mëngjesit ose në kohën e gjumit, sepse është më e lehtë për t'u mbajtur mend. Përveç mbrojtjes nga shtatzënia e padëshiruar, kontraktivët oralë kanë një numër përfitimesh, siç janë zvogëlimi dhe vonimi i gjakderdhjes menstruale, zvogëlimi i shfaqjes së cisteve beninje funksionale dhe trajtimi i dismenoresë. Mangësia kryesore është nevoja përmarrje ditore, e cila shpesh përcillet me mosmarrje të pilules, gjë që nga ana tjeter nxit gjasat e shtatzënisë.

Përveç kontraktivëve oralë, ekzistojnë edhe kontraktivë oralë që përbajnë vetëm progestogen. Ata janë të përshtatshëm për gratë te të cilat kundërndikohet përdorimi i kontraktivëve që përbajnë estrogjen, siç janë kontraktivët oralë.

Pilulat përmarrje urgjente, të njoitura si "pilulat e mëngjesit të nesërm" janë metodë e kontracionit urgjent dhe përdoren në situatat kur një grua ka kryer marrëdhënien seksuale pa mbrojtje. Për efekt më të mirë, tableta duhet të merret brenda 72 orëve nga marrëdhënia seksuale. Siç nënkupton edhe emri i saj, kjo metodë duhet të përdoret vetëm në raste skajshmërisht urgjente dhe kurritësi si një kontraktiv i rregullt ose si mjet parandales.

Kontraktivët e injektuar zakonisht përbajnë progestogenë, por në disa vende ata mund të janë një kombinim i estrogjenit dhe progestogenit. Injekzioni jetet nga një punonjës mjekësor, një herë në muaj ose një herë në tre muaj, në varësi të përbërjes kimike.

Implantet nënlekurore përbajnë progestogenë dhe të njëjtat vendosen në lëkurë, zakonisht në parakrah. Ato sigurojnë kontracionin të vazdueshëm dhe afatgjatë përmes 3-5 vjetësh, në varësi të preparatit. Mangësia e kësaj metode është nevoja përmarrje të vogël kirurgjikale, që është e domosdoshme përmes dixhierjës implantit.

Unaza vajinale është një unazë e vogël, fleksibile, me një diametër prej jo më tepër se 5.5 cm. Kjo lëshon estrogjen dhe progestin, me çka parandalon procesin e ovulacionit. Pas vendosjes në brendi të vajinës, ajo mbahtet 3 javë dhe më pas duhet ta hiqni që të ndodhë gjakderdhja e përmuaqshme.

Fashat transdermale mbahen mbi lëkurën e pjesës së poshtme të barkut, të mollaqeve, pjesën e sipërme të trupit (por jo në gjoks) ose pjesën e jashtme të krahevës. Përberja dhe mekanizmi i veprimit është identik me atë të unazës vajinale. Fasha duhet të ndryshohet çdo javë përmes 3 javësh. Javën e fundit, gjegjësisht janë 4-të duhet ta kaperceni, që të mund të ndodhë gjakderdhja e përmuaqshme.

Çdo grua duhet të jetë e mirinformuar përmes përparesitë dhe mangësitë e kontracionit hormonal para se të fillojë ta përdorë atë dhe duhet medoemos të mbikëqyret nga një gjinekolog.

**KONTRACEPSIONI INTRAUTERIN** Pajisjet intrauterine, të njoitura si spirale, janë një metodë shumë efektive e kontracionit. Ekzistojnë dy lloje: pajisjet intrauterine që përbajnë bakër dhe pajisjet intrauterine të veshura me hormon. Spiralet me bakër veprojnë duke ndikuar në lëvizshmérinë e spermës dhe duke parandaluar kështu fekondimin e qelizës vezë të pjekur, dhe gjithashtu veprojnë në mukozën e mitrës, duke e bërë murin e saj të pafavorshëm përmes implantimin e vezës së fekonduar. Për më tepër, spiralja me bakër mund të përdoret si kontracioni urgjent. Nëse futet brenda 5 ditëve pas marrëdhënieve seksuale të pambrojtor, është metodë efektive e kontracionit me koeficient 99.9%. Pajisjet e tjera intrauterine lëshojnë sasi të vogla të progestogenit në mitër, gjë që e bën mukozën e qafës së mitrës të trashë dhe të padepertueshme përmes spermës dhe gjithashtu zvogëlon lëvizshmérinë e spermës. Vendosja dhe heqja e spiraleve duhet të kryhet gjithmonë nga një gjinekolog.

**KONTRACEPSIONI MEKANIK** përfshin metodat që parandalojnë shtatzënë duke penguar migrimin e lëngut të spermës në vajinë. Ato nuk kanë veprim sistematik, janë të lehta dhe të sigura përmes përdorur dhe nuk kanë pothuajse asnjë kundërndikacion. Përdorimi i tyre ka të bëjë me aktin seksual, përmes arsyesh, përdorimi i drejtë gjatë secilit akt seksual është thelbësor përmes suksesin optimal të metodës.

Këtij grupi i përket një nga metodat më të përdorura të kontracionit dhe ai është prezervativi, i cili është gjithashtu i vetmi kontraktiv që mbron nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme. Preservativi mashkullor (kondomi) përbëhet nga lateksi i hollë dhe është i disponueshëm gjérësisht, i lirë dhe i lehtë përmes përdorur. Preservativi femoror (femidomi) përbëhet nga poliuretani i lubrifikuar paraprakisht dhe ka të njëjtin funksion si kondomi mashkullor. Ai ka formën e tubit dhe dy unaza, një përbrenda dhe një përashta, të cilat nuk lejojnë që të bie në vajinë gjatë marrëdhënieve seksuale.

Diafragma është një kësulë e vogël silikonë që mbulon plotësisht qafën e mitrës dhe kështu parandalon hyrjen e spermës në mitër. Prodhohet në madhësi të ndryshme. Madhësia e diafragmës duhet të përcaktohet nga gjinekologu juaj. Çdo 1-2 vjet duhet të bëhet një kontroll mjekësor përmes ende



## MITET NË LIDHJE ME SHMANGIEN E SHTATZËNISË SË PADËSHIRUAR

përshtatet me madhësinë e saj, sidomos nëse keni luhatje në peshë. Vendoset në vagjinë pak para marrëdhënies seksuale (më së shumti 6 orë para marrëdhënies seksuale). Pas marrëdhënieve seksuale, diafragma duhet të lihet në vagjinë edhe për disa orë, por jo më pak se 6 orë. Përdorimi i shpeshtë mund të çojë në dëmtime të vogla të murit vaginal dhe infeksione urinare ose kërpudhere.

**KONTRACEPSIONI KIMIK** Spermicidet janë kimikate që shkatërrojnë spermët dhe futen në vagjinë pak para marrëdhënies seksuale. Ato vijnë në formë të ndryshme, si kremra, tableta, pastë, xhelatinë, shkumë dhe të ngjashme. Kanë efikasitet të ulët nëse përdoren vetë, por të kombinuara me metodat mekanike japojn një shkallë të lartë mbrojtjeje.

**METODAT NATYRORE TË KONTRACEPSIONIT** përfshijnë abstinencën periodike, gjegjësisht shmangien e marrëdhënieve seksuale gjatë periudhës kur gruaja është pjellore, d.m.th. rreth kohës së ovulacionit. Këto metoda janë të përshtatshme për gratë që mund të përcaktojnë ditët pjellore në ciklin menstrual dhe për çiftet që janë të motivuar të abstenojnë gjatë asaj periudhës.

Ky grup metodash përfshin matjen e temperaturës bazale të trupit, metodën e kalendarit dhe përcjelljen e ndryshimeve në mukozën e qafës së mitrës. Matja e temperaturës bazale përfshin monitorimin ditor të temperaturës, duke u mbështetur në faktin se gjatë ciklit menstrual temperatura bazale ndryshon në paxtim me ndryshimet hormonale. Nga fillimi i menstruacioneve e deri para ovulacionit, temperatura bazale sillet mes 36 deri në 36.4°C. Në periudhën pas ovulacionit, temperatura bazale shënon rritje prej 0.2-0.4°C mesatarisht.

Metoda e kalendarit përfshin numërimin e ditëve të ciklit menstrual, me përdorimin e disa formulave për përcaktimin e ditëve pjellore dhe llogaritës së ndryshëm në internet. Ovulacioni ndodh dy javë para ciklit të pritshëm menstrual.

ass. d-r Iva Malahova Gjoreska  
EPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR  
GINEKOLOGJI DHE AKUSHERI



Urinimi, bërra dush dhe aplikimi i mjeteve të ndryshme në vagjinë, siç janë sapunët, shampot, dezinfektuesit pas kryerjes së marrëdhënies seksuale të shoqëruar me ejakulim në vagjinë nuk do t'ju mbrojnë nga shtatzënia. Pozicioni më këmbë ose çfarëdo pozicioni tjeter nuk do të çojë në rrjedhje të spermës nga organet gjenitale femërore, kështu që kjo metodë nuk është aspak efektive në parandalimin e shtatzënisë.

Përdorimi i dy prezervativëve ose një kombinim i prezervativëve mashkullorë dhe femërorë vetëm mund të rrisë rrezikun e plasartjes së prezervativit për shkak të ferkimit në sipërfaqen e tyre gjatë marrëdhënies seksuale.

Ushqyerja me gjii nuk është një metodë e besueshme e kontracepcionit, ngaqë kjo e vonon, por nuk garanton mungesën e ovulacionit.

Në një cikël ideal 28-ditor, ovulacioni pritet në ditën e 14-të që nga dita e parë e gjakderdhjes menstruale. Duke qenë se gjatësia e ciklit normalisht mund të sillet nga 24 deri në 35 ditë, ovulacioni mund të pritet nga dita e 10-të deri në ditën e 18-të, në varësi të komizës themelore kohore të ciklit, por gjithmonë dy javë para gjakderdhjes së pritshme, për shkak të pandryshueshmërisë së fazës së dytë të ciklit.

Përcjellja e ndryshimeve në mukozën e qafës së mitrës (sekrecionet vaginal) – duke vëzhguar ndryshimet në pamjen e sekrecioneve, ju mund të përcaktoni kur ka më shumë të ngjarë të ndodhë ovulacioni. Në periudhën rrëth ovulacionit, sekretimi i mukozës së qafës së mitrës rritet, ajo fryhet, bëhet më elastike, kurse për të shmangur shtatzënинë në këtë periudhë, kërkohet abstinencë.

Suksesi i metodave natyrore varet shumë nga angazhimi i partnerëve dhe gjasat për të dështuar janë më të larta se te metodat e tjera të kontracepcionit, sepse shenjat dhe simptomat që e shoqërojnë ovulacionin nuk janë gjithmonë të qarta. Metoda më e vjetër natyrore e kontracepcionit është coitus interruptus – nxjerja e organit gjenital para ejakulimit. Konsiderohet si një metodë shumë e pasigurt, sepse shkarkimi i spermës mund të vijë përpëra se të ndodhë ejakulimi. Prandaj, nëse doni të shmangni shtatzëninë, është më mirë të përdorni metoda të tjera të kontracepcionit.

E vetmja metodë e përhershme e kontracepcionit është sterilizimi kirurgjikal. Është një procedurë shumë efektive, që shoqërohet nga një shkallë e ulët e komplikimeve si të femrat ashtu edhe të meshkujt. Te femrat, procedura përfshin lidhjen ose vënien e unazave përreth tubave të Fallopit. Te meshkujt, procedura përfshin bllokimin e kanaleve të bartjes së spermës, procedurë e njojur si vazektoni.

## Një mundësi e re terapeutike për të mbështetur trajimin e anemisë që vjen nga shkaqe të ndryshme

Dr. Irena Eftimovska Rogaç,

Subspecialiste e gastroenterohepatologjisë, SPQ "8 Shtatori"

Hekuri është një element kimik i domosdoshëm për rreth 200 reaksione biokimike në trupin e njeriut dhe është faktor i rëndësishëm në proceset e prodhimit të energjisë, transportit të oksigjenit, funksionimit të duhur të sistemit imunitar, prodhimit të hormoneve, neurotransmetuesve dhe ADN-së. Për këtë arsy, shëndeti i përgjithshëm varet në masë të madhe nga sasia e hekurit që marrim. Megjithatë, mungesa e hekurit është një nga pamjaftueshmëritë më të zakonshme ushqyese. Njerëzit, siç janë fëmijët, të mosh Sot, njihen disa forma të ndryshme të shtesave, përbërësi kryesor i të cilave është hekuri, i cili gjendet në formën e fumaratit të sodiumit, sulfatit dhe bisglicinatit. Këto kripëra kontribuojnë në qëndrueshmërinë e preparatit dhe biodisponueshmërinë më të mirë.

Përveç formulimeve ekzistuese të shtesave të hekurit në formën e fumaratit dhe sulfatit, përdorimi i bisglicinatit të hekurt është po ashtu në rritje. Studime të shumta ndërkombëtare kanë treguar se bisglicinati i hekurt tregon epërsi në numrin më të madh të veçorive, të cilat përcaktojnë efikasitetin e shtesave të hekurit. Në krahasim me formulimet në formën e fumaratit dhe sulfatit, bisglicinati i hekurt përthitet 2-4 herë më me efikasitet në aparatin e tretjes. Prandaj, ndërsa biodisponueshmëria e formulimit të hekurit në formën e fumaratit dhe sulfatit është 27-28%, në bisglicinatin e hekurt është jashtë çdo krahasimi, me rreth 90%. Një nga arsyet më të rëndësishmet përsë biodisponueshmëria e bisglicinatit të hekurt është aq e lartë është aftësia e tij për t'u lidhur me dy molekula të aminoacidit glicinë. Ai siguron stabilitet në sistemin e tretjes, parandalon zërthimin e tij dhe zgjedhon aftësinë e tij për të reaguar me substancë të tjera ushqimore, veçanërisht ato që pengojnë përthithjen e hekurt, të tilla si polifenollet, fitatet dhe taninet (siç është rasti i sulfatit ose fumaratit). Kjo lejon që bisglicinati i hekurt të ruajë tretshmëri të lartë, si në mjediset acide të ashtu edhe në ato alkaline në aparatin e tretjes.

Prandaj, fumarati i hekurt dhe sulfati i hekurt shpesh mund të shkaktojnë efekte anësore, të tilla si të përziera, kapsllëk, diarre, fryrje dhe jashtëqitje të zeza. Nga ana tjetër, një nga përparësítë e mëdha të bisglicinatit të hekurt është pa dyshim efekti i tij më pak oksidues në mukozën e stomakut dhe pjesët e sipërme të aparatit të tretjes. Ky është një fakt Jashtëzakonisht i rëndësishëm që tregon për një zhvillim dukshëm më të ulët të efekteve anësore të bisglicinatit të hekurt, krahasuar me fumaratin e hekurt dhe sulfatit e hekurt. Përveç kësaj, pasi të resorbohet, bisglicinati i hekurt zërthet, hekuri çlirohet menjëherë dhe përdoret për të rimbushur rezervat, ndërsa glicina përdoret në biosintezën e acideve nukleike dhe proteinave në qeliza.

Përvojat e pacientëve që kanë përdorur preparatin me bisglicinat të hekurt, New Iron, tregonjë se depoja e hekurt arrin të plotësohet brenda tre muajve, ndërsa vlera e hekurt në gjak normalizohet për gjashtë muaj. Përveç kësaj, kapsula e preparatit New Iron përmban elemente të tjera të rëndësishme, si acidi folik dhe vitamina B12, të cilët janë faktorë të pazëvendësueshëm në procesin e sintezës së qelizave, si dhe vitaminën C, e cila është një nga faktorët më të rëndësishëm të nevojshëm për rritje dhe zhvillim, shërimin e plagëve, sintezën e kolagjenit, përthithjen e hekurt, funksionin e sistemit imunitar dhe mirëmbajtjen e gjendjes fiziologjike të eshtrave, kërcit dhe dhëmbëve.

Bisglicinati i hekurt është për momentin një mundësi e përshtatshme si për ata që kanë nevojë për plotësim të hekurt përmes shtesave ushqimore, ashtu edhe për njerëzit plotësish të shëndetshëm, pasi pothuajse përjashton plotësish mundësinë e shfaqjes së efekteve anësore, ofron përthithje dhe ruajtje optimale, si dhe përmirësim dhe mirëmbajtje të shpejtë dhe më efikase të nivelit të hemoglobinës në krahasim me formulimet konvencionale të hekurt të përdorura deri më sot.

**New Iron®**  
Formulim inovativ dhe i plotë për trajimin e anemisë që vjen nga shkaqe të ndryshme

**Pa ndjenjë të përzieres dhe efekte të tjera anësore**

Vetëm hekuri nuk mjafton!  
Për eritrocitopozën e duhur nevojiten edhe mikroelemente të tjera.

- Bisglicinat hekuri 90 mg**  
Merr pjesë në procesin e krijimit të gjakut dhe zhvillimit të indeve gjatë shtatzenisë  
Merr pjesë në zgjelimin e lodijs dhe ndjenjës së lodijs
- Vitaminë B12 9 µg**  
Merr pjesë në krijimin e qelizave të kuqe të gjakut, përhapjen e qelizave, metabolizmin normal  
dhe krijimin e energjisë  
Merr pjesë në funksionimin e duhur të sistemit imunitar
- Vitaminë C 180 mg**  
Rrit përthithjen e hekurt dhe merr pjesë në funksionimin normal të sistemit imunitar  
Përspejton energjinë e organizmit, përkatesisht zgjedhon lodijs dhe ndjenjë së lodijs



**МЕРИ ГО ТВОЈОТ  
КРВЕН ПРИТИСОК,  
КОНТРОЛИРА ГО,  
ЖИВЕЈ ПОДОЛГО**  
**ОД СÈ ❤  
ЗАБЛАГОДАРИ  
ИМ СЕ НА  
ТВОИТЕ ХЕРОИ**



ЗДРУЖЕНИЕ НА КАРДИОЛОЗИ  
НА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Драги пациенти,

Во моментот кога светот застана, здравствените професионалци — лекарите и фармацевтите, беа тука за сите нас.

Додека медицината го бара решението за овој глобален проблем, тие се тука да ја олеснат оваа битка.

Да земеме активно учество во борбата за нашето здравје, за здравјето на нашите најблиски, за здравјето на сите нас.

Алкалоид АД Скопје, Здружение на Кардиолози на Северна Македонија и фармацевтите оваа година заедно се приклучуваат кон одбележување на Светскиот ден на срцето и на Светскиот ден на хипертензијата.

Затоа, заедно традиционално да ги одбележиме овие денови и да дадеме придонес кон нашето здравје. Да бидеме пример дека заедно можеме. Да бидеме пример дека се грижиме за нашето здравје.



*Здравјето прег сè*

# Çka është OKLUZIONI?



Okluzioni (kafshimi) është mënyra në të cilën dhëmbët e sipërme dhe ato të poshtëm përputhen në mes vete kur personi e ka gojën të myllur. Malokluzioni paraqet një mospërputje midis dhëmbëve në harkun e sipërme dhe të poshtëm të dhëmbëve kur takohen nofulla e sipërme dhe e poshtme gjatë myllje së gojes. Me fjalë të tjera, malokluzioni është çdo devijim i okluzionit nga normalja. Në vlerësimin e malokluzionit është thelbësore të merren parasysh estetika dhe funksionaliteti.

Nëse këto aspekte janë të pranueshme për personin, përkundër përkufizimit zyrtar të malokluzionit, atëherë trajtimi mund të mos jetë i nevojshëm.

Në ortodonci, malokluzionet ndahen në disa klasa.

Ndoshta efekt më negativ në mirëqenien psikosociale ka e ashtuquajtura klasa III (e tretë)

e malokluzionit - prognatizmi. Shenja më e spikatur e malokluzionit të klasës III është mungesa e harmonisë së fytyrës, e cila në profil karakterizohet nga një e treta e poshtme e fytyrës tejet e theksuar, gjegjesiht mjekra është "e nxjerrë përparrë", ndërsa perballë - një treta e poshtme e fytyrës e shkurtuar.



Shpesh tek individët e tillë ka një rritje të tepertë të nofullës së poshtme në krahasim me të sipërmen. Shenjë karakteristike në gojë është shquarja më e madhe e dhëmbëve të përparmë të poshtëm, gjegjesiht dhëmbët e përparmë të poshtëm janë të vendosur përparrë atyre të sipërme.

Mbizotëni i kësaj anomalie në popullatë është 2-4% dhe zakonisht ka faktor trashëgues, ndërsa frekuencia e saj varet nga mosha dhe variacionet gjeografike. Studimet tregojnë se prognatizmi vërehet që në pubertet. Për herë të parë të një individ kjo gjendje gjendet te të porsalindur në muajin e dytë (në këtë periudhë është një gjendje normale) dhe zakonisht zhduket në muajin e katërt. Në disa raste, veçanërisht kur fëmija lind para kohe, kjo gjendje mund të mbetet.

Një nga arsyet më të rëndësishme për korrigimin e kësaj gjendjeje është ana estetike dhe funksionale. Gjendja mund të ketë një ndikim psikologjik tek personi, duke rezultuar në vetëbesim të ulët dhe gjithashtu veshtrësi në të folur dhe në përtypjen e ushqimit. Një nga opsonet për korrigimin e kësaj anomalie është e hershme përshtatje përmes modifikimit e rritjes, e ashtuquajtura maskë e Ilojtit Delaire (Delaire mask) ose maskë e fytyrës. Përshtatja përbëhet nga dy pjesë: proteza fiksë, që vendoset në gojë dhe mbahet gjatë gjithë kohës dhe pjesa e jashtme apo maska, e cila mbahet 12 orë në ditë, të paktën për 6 muaj, sipas nevojës. Kontrolllet bëhen te ortodontisti juaj, në fillim një herë në disa ditë, ndërsa më vonë dy herë në muaj e më rrahë. Kjo përshtatje stimulon rritjen e nofullës së sipërme dhe të dhëmbëve përparrë dhe përposh, ndërsa nofulla e poshtme lëviz përmbrapa dhe përpjetë. Kjo metodë është e vetmja që mund të arrinë rezultatet më të mira dhe është optimale që fëmijët të fillojnë ta mbajnë në periudhën nga viti i tetë dhe i nëntë i jetës. Sa më e gjatë terapija, aq më pak ka gjasa që gjendja të kthehet pas trajtimit. Menjëherë pas heqjes së maskës, jepet një përshtatje ruajtëse, e cila mbahet për të ruajtur rezultatet e arritura të terapive.

Nëse te fëmijët e moshës 5-6 vjeç, megjithëse dhëmbët e përhershëm nuk kanë mbirë ende, vëreni shquarje të tepruar të nofullës së poshtme, ndërsa dhëmbët e përparmë të poshtëm janë të vendosur përparrë dhëmbëve të përparmë të sipërme, është e nevojshme të konsultoheni me një ortodontist sa më shpejt të jetë e mundur për të filluar me terapi.



**Dr. Katerina Nikollovska**  
Doktoreshë e stomatologjisë  
Specialiste e ortodoncise

## PROBIOTIKËT DHE PËRDORIMI I TYRE PËR FORCIMIN E SISTEMIT IMUNITAR

Sipas përkufizimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, probiotikët janë mikroorganizma të gjallë të quajtur baktere "të mira", përdorimi në sasi të mjaftueshme i të cilave ka një efekt të dobishëm në shëndetin e njeriut.

Në traktin gastrointestinal të trupit të njeriut, gjegjesiht në zorrë, ka mikroflorë (bakterë) që janë të rëndësishme për maturimin dhe zhvillimin e sistemit imunitar. Probiotikët ndihmojnë në mirëmbajtjen e shëndetit, veçanërisht të funksionit imunitar. Probiotikët ndihmojnë në baraspeshimin e shëndetit, veçanërisht të funksionit imunitar. Probiotikët ndihmojnë në baraspeshimin e shëndetit, veçanërisht të funksionit imunitar. Probiotikët ndihmojnë në baraspeshimin e shëndetit, veçanërisht të funksionit imunitar.

Probiotikët e përdorur më shpesh janë lloje të ndryshme të gjinisë Bifidobacterium (banorë normalë të zorrës së trashë) dhe Lactobacillus. Studime të shumta kanë treguar se probiotikët ndihmojnë në mirëmbajtjen e shëndetit, veçanërisht të funksionit imunitar. Me ruajtjen e funksionit normal gastrointestinal, parandalohen infeksionet, ndërsa prishja e baraspeshës së baktereve "të mira" dhe "të këqia" është kusht për shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme. Nuk thuhet koton se stomaku i shëndetshëm do të thotë trup i shëndetshëm.



A duhet të merren probiotikë për të parandaluar dhe për t'u mbrojtur nga koronavirusi?

Koronavirusi është infekzion i ri dhe shumë gjëra janë të panjohura, por ajo që mund të bëjmë, përvèç distancës sociale dhe higjienës, është pa dyshim të rrisim marjen e probiotikëve dhe kështu të stimulojmë sistemin tonë imunitar dhe ta ndihmojmë atë në luftën kundër koronavirusit.



**Gabriela Kaçakoska-Naneska**  
Farmaciste e diplomuar  
IPSH BARNATORE BIOLEK 3, PRILEP

# Хербион®



КАШЛИЦАТА  
МОЖЕ ДА ДОВЕДЕ  
ДО НЕПРЕДВИДЛИВИ  
ПОСЛЕДИЦИ

Сирупите Хербион се традиционални хербални лек.



НОВА  
ФОРМА

Активните супстанции во Хербион сирупите и пастилите овозможуваат да се справите со кашлицата и последиците од неа.

**ХЕРБИОН®**  
СЕ СПРАВУВА СО КАШЛИЦАТА.

[www.herbion.mk](http://www.herbion.mk)

KRKA

Пред употреба внимателно да се прочита упатството! За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејства на лекот консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.

# USHTRIME PËR TRAJTIMIN E VËSHTIRËSIVE PSIKOLOGJIKE

Ekzistojnë një sërë emrash që përdoren për ankthin, siç janë rënësë, shqetësim, panik, nervozizëm, tension, ndjesia se personi është nën stres. Të gjitha këto shkaktojnë një gjendje të përgjithshme të pakëndshme, që shoqërohet nga një varg simptomash fizike dhe mendore, të cilat shfaqen në situata që individi i sheh si kërcënuese ose të rrezikshme. Parehatia ndodh pavarësisht nëse bëhet fjalë për rrezik real apo të imagjinuar dhe mund të përjetohet si një shqetësim i vogël e deri në panik të madh.

Ankthi është pjesë përbërëse e jetës dhe të gjithë njerëzit përballen me të kohë pas kohe. Të gjithë ne përjetojmë ankth kur e gjejmë veten në situata stresuese, për shembull kur na presin takime të rënësishme, kur i nënshtrohemi ekzaminimit, kur jemi në pritje të rezultateve të ekzaminimit. Kur ndodhemi në situata stresuese zakonisht jemi të zënë me situatën e atypëratyshme, gjë që mund të ndikojë në sjelljen tonë.

Si ta njohim?



Ankthi shprehet me një varg simptomash fizike, si rrahje të shpejta të zemrës, djersitje, dridhje e duarve ose trupit, tharje e gojës, vështirësi në fryshtëzim, të përziera në stomak, një ndjenjë nxehtësie, tension muskular, ndjesia se nuk mund të çlodhemi, gungë në fyt.

Simptomat psikologjike që e shoqërojnë ankthin janë një ndjenjë e dobësisë së përgjithshme, marramendje, ulje e përqendrimi, frikë nga vdekja, të sëmurët kanë frikë se do të humbasin kontrollin e sjelljes së tyre, një ndjenjë shqetësimi i fortë, një ndjenjë se në çdo moment mund të ndodhë diçka e pakëndshme. Kur shfaqen këto simptoma si



përgjigje ndaj një situate të cilën personi e pret dhe nga e cila shqetësohet, bëhet fjalë për ankthin e pritshëm për të cilin personi nuk duhet të shqetësohet. Por kur disa simptoma janë të vazhdueshme ose shfaqen gjatë një sulmi paniku ose në një situatë të veçantë nga e cila personi nuk ka frikë, atëherë bëhet fjalë për çrregullim ankthi.

## Shfaqja e simptomave



Paraqitja e çrregullimit të ankthit ndikohet nga faktorë të ndryshëm, siç janë përvojat e fëmijërisë, situatat stresuese, ndjeshmëria individuale, mënyra e përballjes me stresin. Përvojat e fëmijërisë mund të lidhen me ekspozimin ndaj ndarjes nga një person i rënësishëm, përjetime traumatike etj. Ngjarjet stresuese mund të shkaktohen nga humbja e një personi të rënësishëm, shkëputja e një lidhjeje emocionale, tryrsia në vendin e punës, probleme financiare, sëmundje serioze fizike, ndryshime të mëdha në jetë, si shpërndarje, martesa, lindja e një fëmije. Situatat stresuese të jashtme mund të kontribuojnë në paraqitjen e ankthit, por nuk janë në vetvete të mjaftueshme për të shpjeguar fillimin e ankthit.

Në ballafaqimin me ankthin është e nevojshme të kuptohet besimi individual i personit në lidhje me shkaqet e ankthit. A është kjo ngjarje e jashtme që nuk mund të ndryshohet, a mund të ndryshohet mënyra e interpretimit të kësaj ngjarjeje? Më pas mund të bëhet një plan për zgjidhje të pasojave negative nga kjo ngjarje.

Me t'u shfaqur një herë, ankthi ushqehet përmes simptomave, mendimeve dhe ndjenjave që e rrisin edhe më shumë atë. Falë kësaj lidhjeje, është e mundur të zvogëlohet ndjenja e pakëndshme e ankthit madje deri në pragun e tolerancës. Prandaj është e rënësishme që personave me çrregullim ankthi t'u jepet udhëzim se si ta zvogëlojnë atë.



Ankthi është një reagim i natyrshëm ndaj rrezikut dhe simptomat e ankthit shfaqen sa herë që ekziston një ndjenjë rreziku, e cila mund të jetë objektive ose subjektive. Pavarësisht nëse ekziston apo jo një rrezik real, simptomat me siguri do të shfaqen dhe ato simptoma e përgatisin trupin përrrezik.

Në një gjendje ankthi, trupi reagon sikur është në rrezik dhe përgatitet për një reagim "lufto ose mbathja", që kërkon muskuj të tendosur, që më tej kërkon më shumë oksigjen dhe adrenalinë për të rritur furnizimin me oksigjen dhe për të përshtypuar frysma. Me përshtypimin e frysma mund të paraqiten vështirësi në marrjen e ajrit, muskujt e kraharorit bëhen të tendosur dhe kjo mund të përjetohet si dhimbje në gjoks dhe në kafazin e kraharorit. Niveli i rritur i oksigjenit në gjak mund të çojë në humbje të ndjenjave. Nga ana tjetër, adrenalina çon në rritje të punës së zemrës, tendosje të shtuar të muskujve, gjë që mund të çojë në dhimbje koke, dhimbje qafe, ndjesi shpimi gjilperash rrëth kokës dhe dridhje të muskujve. Efekti i adrenalinës shoqërohet me tharje të gojës, shikim të turbullt, vështirësi në gëlltitje, të përziera dhe djersitje.

## Kontrolli



Pavarësisht nga shkaqet që çojnë në ankth, pikërisht e tij mund të jetë edhe truri, meqenëse ka lidhje psikologjike dhe biologjike. Kuptimi i ankthit në tru i referohet një çekuilibri të neurotransmetuesve të ndryshëm në rajone të caktuara të trurit. Barnat që përdoren për të trajtuar ankthin ndikojnë në këtë çekuilibër dhe zgjedhjnë biologjikisht simptomat e sëmundjes.

Përveç terapisë me barna, ka ushtrime të caktuara që përdoren për të zgjedhuan ankthin. Një nga metodat më efektive është ajo e frysma nga barku. Simptomat që lidhen me frysma janë më të zakonshmet për ankthin. Shumë njerëz që kanë simptoma ankthi i përkqësuar simptomat për shkak të frysma jo të drejtë. Është karakteristike edhe prania e ndjenjës së

gulçimit, që kompensohet me frysma të thellë. Njerëzit që marrin frysma shpejt, marrin frysma nga gjoksi dhe nuk përdorin frysma nga barku, gjë që çon në dhimbje të kafazit të kraharorit. Njerëzit që vuajnë nga ankthi është mirë të marrin frysma përmes hundës dhe barkut.

Kur personi vëren se po merr frysma shpejt dhe kjo ndodh më shpesh për shkak të stresit, këshillohet të veprojë si në vijim:

- Uluni ose mbështetuni në diçka, mban frysma dhe numëroni deri në 10, më pas nxirri frysma dhe i thoni vetes me kokë të qetë "relaksuhu"
- Merrni dhe nxirri frysma në një cikël prej 6 sekondash
- Merrni frysma për 3 sekonda dhe nxirreni për 3 sekonda, kjo është një frekuencë prej 10 në minutë.

Qëllimi i frysma është së drejtë te personat me ankth është që frika të mos përparojë në panik. Më e rendësishme është që së pari të vërehen simptomat e hiperventilitë (frysma e shpejtë) dhe pastaj të zbatohet teknika e frysma nga barku.

Simptomat e ankthit mund të kontrollohen me ndihmën e ushtrimeve të relaksimit, stërvitjes autogjene, kontrollit të simptomave me vizualizim, si dhe duke shmangur frikën fobike, duke zhvendosur vëmendjen dhe duke përdorur lojëra mendore.



dr. Slagjana Angelkoska  
psikologe

# CILAT JANË SFIDAT TUAJANË RRUGËN DREJT ndryshimit?



Me çfarë mendimesh çoheni në mëngjes, cilat janë ritualet tua ja të mëngjesit dhe si ndikojnë ato në mënyrën se si silleni dhe reagoni ndaj situatave të përditshme?

Sfida do të ketë gjithmonë, por mënyra se si përballemi me to është pa dyshim një proces individual. Nëse bëni gjithmonë të njëjtën gjë, do të merrni gjithmonë të njëjtat rezultate. Nëse dëshironi ndryshim, duhet të silleni ndryshe, të ndryshoni mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit, për t'u bërë të vetëdijshëm për emocionet tua ja dhe mënyrën se si reagoni. Dhe, gjëja më e rëndësishme është të ndiqni vetveten.

Shumë njerëz, kur vjen momenti të kuptojnë se kanë nevojë për ndryshim, fillojnë menjehershë të japid arsyetime, të tillë si: nuk kam kohë, para ose energji për të bërë ndryshime. Ata e ulin menjehershë vlerën e asaj që dëshirojnë t'u ndodhë, duke ulur standardet e tyre dhe duke e bindur veten se rezultati që do ta arrinin nëse do të bënin ndryshime nuk është edhe aq i vlefshëm.

Frika nga ndryshimi është më e madhe se dëshira për diçka të re. Ndoshta nuk ka të bëjë edhe aq shumë me frikën nga ndryshimi, por me ndërgjegjësimin për hapat që duhen ndërmarrë për të arritur synimet. Atëherë, çfarë mund t'ju ndihmojë për të ndryshuar më lehtë zakonet tua ja kufizuese, të përvetësoni rituale të reja të mëngjesit ose të bëni ndonjë ndryshim që kérkon kohë, para dhe/ose mund?

Nga karriera ime e gjatë si trajnere profesioniste, duke punuar me një numër të madh të kompanive dhe individëve në të gjithë botën, duke i udhëhequr përgjatë një procesi ndryshimi, kam arritur në përfundimin se

arsyeja përsë shumë njerëz mbeten pre e zakoneve të vjetra e joproductive, ndërsa disa të tjerë lëvizin me lehtësi përmes ndryshimeve, është sepse ata e matin dhe vlerësojnë kohën ndryshe.

Ekzistojnë 2 lloje njerëzish: disa nuk kanë kohë, ndërsa të tjerët kanë kohë! Në të vërtetë, të gjithë njerëzit në planet kanë 24 orë në dispozicion. Dallimi qëndron në atë se disa e matin kohën sipas mënyrës se si e kanë kaluar, ndërsa të tjerët sipas mënyrës se si e kanë investuar!

Parafytyroni si do të ishte sikur që tani e tutje të investoni me vetëdije kohën, paratë dhe energjinë tuaj dhe të filloni të jetoni me dijeninë se gjithçka është një investim? Në bazë të rezultatit, ju matni dhe dini të thoni se keni shpenzuar kohë, para dhe energji, pa qenë të vetëdijshëm se gjithçka është një investim. Në fakt, ka të bëjë me vetëdijen se si e planifikoni kohën tua, gjegjësisht si, ku dhe në çfarë e investoni atë.

Tani që e keni këtë dijeni, pyeteni veten se në çfarë jeni duke e investuar pa vetëdije kohën tua, nëse vazhdimisht po e bindni veten se nuk keni kohë për të ushtruar, për t'u ushqyer në mënyrë të shëndetshme, për shëtitje në natyrë dhe një numër aktivitetesh të tjera që do t'ju sjellin shëndet të mirë dhe do t'ju mbushin me energji?

A e investoni kohën tua më shumë sesa duhet në rrjete sociale, duke parë televizor, duke zhvilluar biseda të paqëllimta që "ju shterin energjinë", duke analizuar gjithçka që po ju ndodh në jetë, punë, në marrëdhëniet me njerëzit, duke kërkuar përsosmërinë në rregullimin e mjedisit në të cilin jetoni, si dhe në

një sërë aktivitetesh dhe ritualesh të tjera që ju lodhin dhe "shpenzojnë kohën, paratë dhe energjinë"?

Shkaqet që ju pengojnë për të mos bërë ndryshime janë në kokën tuaq dhe rrjedhin nga bindjet personale. Ju mund t'i ndryshoni lehtësisht ato duke investuar me vetëdije kohën, paratë dhe energjinë në diçka që ju plotëson jo në diçka që ju rraskapit dhe sjell rezultate të padëshiruara.

**E KENI JU NË DORË  
TË VENDOSNI NËSE  
DO TË SHPENZONI  
OSE INVESTONI!**




*Marina Ançevska*

THEMELUESE E QENDRËS PËR PSIKOLOGJI TË BIZNESIT, NLP  
SISTEMIKE, EJL  
KRYETRAJNERE PËR NLP  
SHKRIMTARE  
MËSUESE E JOGËS



# LIVSANE

## LIVSANE Ампули за зголемување на имуниот систем



Viamedi Healthcare GmbH, Deutschland



Европа Лек Фарма ДООЕЛ, Скопје, Р. Македонија

**Пред употреба внимателно да се прочита упатството! За  
индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејства на граничниот  
производ консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.**

# Sa jetesë të shëndetshme bëni?

## 1. Sa orë flini?

- A) Nuk u kushtoj vëmendje orëve, por ndonjëherë më mjaftojnë edhe 3-4 orë
- B) Mundohem të bëj të paktën 6 orë gjumë, por zakonisht nuk ia dal mbanë
- C) Gjumi është shumë i rëndësishëm për mua, ndaj shkoj në shtrat herët për të fjetur më shumë se 8 orë

## 2. Kur zgjoheni...

- A) Bëj menjëherë kafe
- B) Mundohem të ha mëngjes para se të largohem nga shtëpia
- C) Meditoj dhe pi lëng frutash të shtrydhur

## 3. Mëngjesi juaj më shpesh përbëhet nga...

- A) Çfarëdo qoftë. Unë nuk bëj kurrë plan se çfarë do të ha për mëngjes
- B) Varet nga obligimet, por dua që të jetë një mëngjes i pasur me energji
- C) Bukë e përgatitur në shtëpi, sallatë me fruta organike dhe vezë shtëpie

## 4. Gjatë ditës zakonisht pini:

- A) më shumë se 2 kafe
- B) 2 kafe dhe shumë ujë
- C) ujë

## 5. Sa ujë pini gjatë ditës?

- A) Nuk i vë masë, pi kur ndjej etje
- B) Mundohem të pi më shpesh
- C) Pi më shumë se 2 litra

## 6. A i kushtoni vëmendje përbajtjes së produkteve që blini?

- A) Nuk e lexoj asnjëherë përbajtjen
- B) Zakonisht përpiqem të bëj kujdes
- C) I kontrolloj gjithmonë afatet dhe përbajtjen e produkteve

## 7. Sa i kushtoni vëmendje dozës ditore të vitaminave dhe minraleve?

- A) Nuk praktikoj marrje shtesë të vitaminave dhe minraleve
- B) Në periudha të caktuara të vitit, blej shtesa ushqimore
- C) Vitaminat dhe mineralet janë pjesë e shprehive të mia të përditshme

## 8. Si e shfrytëzoni kohën tuaj të lirë?

- A) Rrallë kam kohë të lirë, prandaj e shfrytëzoj çdo mundësi për t'u çlodhur para televizorit
- B) Rri me të afërmit e mi
- C) Për çfarëdo aktiviteti fizik

## 9. Sa shpesh ushtroni?

- A) Shumë rrallë
- B) Mundohem të jem aktiv/e sa herë që kam shoqëri
- C) Rregullisht

## 10. Si e motivoni veten për një shprehi të caktuar të shëndetshme?

- A) Këshillohem me njerëzit përreth meje dhe nisem nga përvaja e tyre
- B) Bëj një listë me arsyet se pse duhet të ndryshoj një shprehi të caktuar
- C) Jeta e shëndetshme është rezultat i shprehive të shëndetshme dhe është vetveti një motivim i vazhdueshëm

## 11. Dietat për ju janë?

- A) Humbje kohe
- B) Dicëka me të cilën në periudha të caktuara të jetës duhet të kthehem i në formë
- C) Nuk bëj dietë sepse kujdesem për mënyrën e shëndetshme të të ushqyerit

## 12. Nëse jeni në dietë dhe dikush ju ofron ushqim me shumë kalori, që do t'ju prishë dietën?...

- A) S'ka gjë nëse e prish një herë
- B) Do të përbahem, por do ta shqyrtoj ofertën
- C) Nuk do të dorëzohem

## Shumica e përgjigjeve nën A

Gjëja më e rëndësishme për ju është të shijoni momentin dhe të mos e çani kokën se si ndikojnë "kënaqësítë" e vogla në jetën tuaj. Ju shpesh kaloni nièpër periudha kur dëshironi të ndryshoni disa zakone, por megjithatë ju duhet shumë motivim për të ndryshuar. Nëse nuk keni një problem të veçantë shëndetësor, nuk jeni adhurues i vizitave te mjeku.

## Shumica e përgjigjeve nën B

Edhe pse nuk jeni të mbingarkuar me pamjen tuaj dhe mënyrën e shëndetshme të jetesës, ju jeni një nga ata që duan të udhëhiqen nga njerëz shembullorë dhe i lakmoni njerëzit e disiplinuar kur është fjala për një jetë të shëndetshme.

## Shumica e përgjigjeve nën C

Një mënyrë jetese e shëndetshme nuk është problem fare, sepse ju thjesht funksiononi në atë mënyrë. Trupin dhe shpirtin i keni në krye të listës së përparrësive dhe nuk doni të devijoni nga gjërat që ju bëjnë të lumtur dhe të shëndetshëm.

органички производ

СЕНТИС +  
бодбодок на Исправа

### УНИКАТНА КОМБИНАЦИЈА ЗА ОСЛОБОДУВАЊЕ ОД СТРЕСОТ

содржи екстракт од валеријана, маточина,  
сладок портокал (Serenzo™) и витамин B6

Внималено одбрани 4 природни активни компоненти во Сентис+  
ќе ќе обезбедат чувство на баланс и хармонија во напорниот животен стил:

- нормална функција на нервниот систем, нормална психолошка функција и намалување на замор и исцрпеност
- намалување на нервоза и напнатост, оптимална релаксација од стресот и поддршка на физичката благосостојба
- помага во одржување на нормален сон и го олеснува заспивањето



Дозирање: за лица постари од 18 години, 2 капсули на ден.

БИОНИКА  
ФАРМАЦЕУТИЧКА  
www.bionikapharm.com

# MJEKËSIA ESTETIKE - një disiplinë në rritje!



Është emocionuese që estetika po përhapet me të madhe dhe është pjesë e mjekësisë bashkëkohore. Megjithatë, sa herë që përmendet fjala estetikë, mendja na shkon menjëherë te gjendjet e ndryshme dermatologjike dhe kozmetike, siç janë plagët, toni i humbur i lëkurës, rrudhat, pigmentimi, korrigimi jokirurgjik i hundës, thithja jokirurgjike e dhjamatit, fryrja e buzëve etj.

Përveç gjendjeve të mësipërme kozmetike, sot si procedura më të zakonshme mund të veçohen:

- Procedurat me Botox për sheshimin e rrudhave
- Pilingjet kimike
- Mikrodermoabrazioni
- Konturimi i fytyrës
- Trajtimet për lipolizë jokirurgjike
- Përdorimi i mbushësve
- Mezoterapia
- Trajtimi PRP (Platelet Reach Plasma)
- Aparatet për analiza të plota të lëkurës

## Momenti kyç

Momenti kyç në marrjen e vendimit për çfarëdo ndërhyrje është zgjedhja e mjekut. Zgjidhni një mjek i cili ka njohuri të mira për anatominë e fytyrës, si dhe procesit natyror të plakjes, pasi këto dy gjëra janë thelbësore në përgjedhjen trajtimit të duhur për fytyrën tuaj.

## Konsultimi dhe procedura

Konsultimi para procedurës është gjithmonë i mirëseardhur. Konsultimi ju lejon të shtjelloni problemin tuaj dhe të merrni një mendim ekspert për ndryshimet që dëshironi të bëni. Është me rëndësi të dëgjohet mendimi i pacientëve, të zbuloni se si ndihen, çfarë mendojnë për pamjen e tyre dhe çfarë duan të ndërmarrin. Mjeku është i detyruar të shpjegojë procedurat e zgjedhura, si dhe materialet që do të përdoren te pacienti. Është e nevojshme të dihet se në mesin e përgjedhjes së madhe të produkteve dhe materialeve estetike ka shumë produkte të paligjshme që fatkeqësisht ofrohen më lirë, por me pasoja të mëdha për pacientin. Kjo është arsyja pse këshillimi falas me mjekun ofron përgjigje për të gjitha pyetjet tuaja.

## Procedurat për muajin shtator


Pas pushimeve verore, lëkura ka nevojë për rigjenerim. Trajtimet më të rekomanduara për këtë periudhë të vitit janë: piling i butë kimik për biorevitalizim të lëkurës, trajtimi PRP dhe mezoterapia e duhur. Trajtimi PRP njihet gjithashtu si lëngu i artë plot me faktorë të rritjes, të cilët janë përgjegjës për shërimin e qelizave të dëmtuara. Ai vjen nga gjaku juaj dhe mund të aplikohet me teknika të ndryshme, si dhe në kombinim me mezoterapinë. Është një trajtim i shkëlqyeshëm kundër plakjes, plagëve të akneve, për nxitjen e rritjes së flokëve dhe shumë më tepër.

Ekziston një produkt i duhur dhe mënyrë e duhur e trajtimit për secilin indikacion. Kemi mundësi ta modelojmë tërë fytyrën me produktet dhe teknologjinë më të fundit të disponueshme për ne.

Bukuria nuk është çështje moshe apo madhësie. Është e rëndësishme të zgjidhni "dorën e mirë" edhe kur korrigioni gabimet më të vogla në lëkurën tuaj.

*Mjekësia estetike ngërthen në vete të gjitha procedurat mjekësore që kanë për qëllim përmirësimin e pamjes fizike dhe kënaqësinë e pacientit, duke përdorur procedura invazive që duhet të kryhen nga një dermatolog ose kirurg plastik, i cili është trajnuar në këtë drejtim.*

**Dr. Simona Popovska**  
Specialiste e Dermatovenerologjisë



# HOROSKOP

## Tetor



DASHI 21.03-20.04

Ky do të jetë një muaj në të cilin do të duhet të keni shumë kujdes për sa i përket shëndetit tuaj. Yjet ju rekomandojnë që të keni kujdes, sidomos me pjesën e sipërme të trupit. Nëse filloni të merreni me ndonjë sport, kini kujdes nga dëmtimet.



DEMI 21.04-20.05

Është koha t'i ktheheni aktivitetit të rregullt fizik. Nëse keni kaluar një periudhë të gjatë dhe pasive nga ana fizike, tanë duhet të bëni plan të ri për një dietë të shëndetshme dhe një agjendë të disiplinuar sportive.



BINJAKËT 21.05-20.06

Këtë muaj, përqendroni vëmendjen tuaj në mbrojtjen e syve. Kini kujdes nga infekzionet e shkaktuara nga pluhuri dhe papastërtitë. Shmangni ngrënien e ushqimit të pashëndetshëm, pasi mund të shkaktojë shqetësimë në stomak dhe çrrugullime të sistemit të tretjes.



GAFORRJA 21.06-20.07

Ju pret një muaj në të cilin do të ndiheni shumë energjik, prandaj mundohuni të përqendroni të gjitha përpjekjet tuaja në gjerat që do t'ju bëjnë edhe më produktiv. Shumë anëtarë të kësaj shenje do të përdojn krijimtarinë e tyre për vepra të reja.



LUANI 21.07-21.08

Lëvizja e planetëve tregon se këtë muaj do të mbizotërojë mirëgenia në jetën tuaj. Kini kujdes nga dhimbjet e muskujve dhe dëmtimet e kyçeve. Mermi sasi më të mëdha të vitaminave dhe mineraleve. Shmangni vendet e mbushura me njerëz dhe ushqimin e shpejtë.



VIRGJERËSHA 22.08-22.09

Nëse keni të përziera ose ndonjë shqetësim tjeter pas ngrënies, duhet të ndryshoni diëten tuaj. Problemet e vogla shëndetësore që ne i quajmë të parëndësishme, nëse nuk përcillen sa duhet, mund të kthehen në sëmundje të rënda. Gjatë kësaj periudhe, yjet ju rekomandojnë të pini sasi më të mëdha të çajit.



PESHORJA 23.09-22.10

Yjet ju premtojnë një muaj në të cilin nuk do të përballeni me ndonjë problem shëndetësor më serioz. Megjithatë, kujdesuni për gjumin, i cili kohë e fundit po ju shkakton vështirësi. Pjesa më e ndjeshme e trupit tuaj do të jetë fyti, të cilin duhet ta mbroni duke shbangur pijet e ftohta.



AKREP 23.10-22.11

Ndikimet planetare tregojnë një periudhë në të cilën duhet të kujdeseni shumë më tepër për imunitetin tuaj. Megjithëse nuk parashikohen probleme serioze të shëndetit, trupi juaj prapëseprapë ka nevoje për më shumë vitamina dhe minerale që të mbrohet nga sëmundjet e padëshiruara.



SHIGJETARI 23.11-20.12

Mbrëmjet e vona dhe ushqimi i pashëndetshëm që keni ngrënë në të kaluarën do të fillojnë të kenë efekte negative në trupin tuaj dhe do t'ju shkaktojnë shtim në peshë. Për t'u rikthyer në formë, ju duhet motivim të cilin mund ta gjeni te miqtë tuaj. Organizohuni me të afermit tuaj dhe është koha për ushtrime!



BRICJAPI 21.12-19.01

Në tetor, përvèç mirëgenies së mirë, parashikohet një periudhë në të cilën më në fund do të vendosni ekilibrin midis jetës private dhe karrierës. Zvogëlimi i situatave stresuese në jetën tuaj të përditshme do t'ju bëje të ndiheni të freskët dhe pozitiv.



UJORI 20.01-18.02

Mos i shpërfillni simptomat fillestare të ftohjes së zakonshme dhe nëse ndiheni të këputur, lejojini vetes një pushim që do t'ju rikthejë energjinë që ju nevojitet. Nëse po kaloni një periudhë të vështirë në të cilën përballeni me probleme të caktuara, është koha të bëni ndryshime të vogla në jetën tuaj të përditshme dhe të ndani kohë përveten.



PESHORI 19.02-20.03

Megjithëse planetët nuk parashikojnë çrrugullime serioze të shëndetit, ju përsëri mund të përballeni me sëmundje të tillë, si ftohje ose kollë, në këtë kohë të vritit. Nëse këto dukuri shqetësuese ju zgjasin, vizitonи menjëherë mjekun tuaj.



## MANASTIRI

Barnatore Viola  
047-222-235  
Barnatore Neo Farm  
047-224-301  
Barnatore Farm-Zdravje  
047-223-039  
Barnatore Farm-Zdravje 2  
047-242-039

## Demir Hisar

Barnatore Dehi Farm  
047-276-644

## GJEVGJELIA

Barnatore Nima  
034-214-562

## GOSTIVARI

Barnatore Botanik  
042-211-413

Barnatore Diti Farm  
042-122-164

Barnatore Mikrofarm  
042-371-622

Barnatore Pro-Farm  
042-213-132

Barnatore Vivalek 4  
042 313496

Barnatore Diti Farm 3  
042-622-888

## GOSTIVAR F. ÇEGRANE

Barnatore Med-Farm  
042-321-363

## GOSTIVAR F. DOBRI DOL

Barnatore Genius-Farm  
042-311-229

## GRADEC

Barnatore Albi Farm  
071-822-270

## KAVADAR

Barnatore Farmakon-Lek  
043-411-891

Barnatore Farmanea  
043-550-900

## KERÇOVA

Barnatore Herba 1  
045-223-978

Barnatore Herba 2  
045-261-265

Barnatore Blina  
045-222-550

## KOÇANI

Barnatore Fitomed  
033-273-805

Barnatore Higija Farm  
033-271-522

## KR PALLANKA

Barnatore Qytet Kr. Pallanka  
031-375-012

## KRIVOGASHTANI

Barnatore Menta Farm 4  
048-471-987

## KUMANOVE

Barnatore Adonis  
031-411-098

Barnatore Dafina  
031-413-977

Barnatore Isidora  
031-550-635

Barnatore Kamilica  
031-550-603

Barnatore Novalek  
031-422-111

Barnatore Farmalek  
031-416-503

Barnatore Filiz  
031-416-700

Barnatore Kaiser Farm  
078/452-702

Barnatore Zani Farm  
031-445-434

## NEGOTINA

Barnatore Negotino  
043-361-433

Barnatore Negotino 1

## NOVO SELLË

Barnatore Zdravje  
034-522-279

## OHËR

Barnatore Bio-Lek  
046-260-580

Barnatore Kavaj  
046-260-940

Barnatore Pasholi  
046-255-070

Barnatore Planta  
046-250-533

Barnatore Heledona  
046-257-744

## PRILEP

Barnatore 2005 VIVA FARM  
048-400-901

Barnatore Biolek  
048-416-208

Barnatore Karakash 1  
048-414-722

Barnatore Menta Farm1  
048-422-551

Barnatore Ortofarm  
048-436-100

## PROBISHTIP

Barnatore Ema Farm  
032-482-666

## RADOVISH

Barnatore Filip Vtorni  
071-945-549

## RESNJE

Barnatore Sigia-Farm Resnje  
047-454-360

Barnatore Farma-Lek-2005  
047-452-553

## F. DOLLNO PALÇISHTE

Barnatore Losiones Medika  
044-391-025

## SHKUP

Barnatore Aloe  
02-2039-915

Barnatore Ambrozija Farm  
02-3224-399

Barnatore Andra Lek  
02-3225-422

Barnatore Vivalek 1  
02-2617-740

Barnatore Vivalek 2  
02-2562-222

Barnatore Vivalek 3 Creshevo  
02-2573-953

Barnatore GoldMun 2  
02-2616-338

Barnatore GoldMun3  
02-2635-555

Barnatore GoldMun 5  
02-2431-600

Barnatore GoldMun7  
070-269-866

Barnatore GoldMun 8  
02-2666-840

Barnatore Da-Jana-Farm  
02-2655-500

Barnatore Datel Farma  
02-2612-536

Barnatore DNA ANNI FARM 3  
02-2445-935

Barnatore Jasmin  
02-2794-349

Barnatore LAJFLAJN  
02-3075-576

Barnatore Lincura  
02-2434-600

Barnatore Mak Farm  
02-3071-289

Barnatore Makmedika  
02-2031-082

Barnatore Nela Farm  
076-407-000

Barnatore Nika Farm  
02-2572-801

Barnatore Nika Farm 1  
02-2545-111

Barnatore Omega Farm 1  
02-3125-202

Barnatore OmegaFarm 3  
02-3114-086

Barnatore Opium  
02-2440-335

Barnatore Oskar lek  
02-3132-227

Barnatore PavloFarm  
02-2467-589

Barnatore Polin  
02-2432-002

Barnatore Regina  
02-2622-205

Barnatore Sara Farm 1  
02-2792-880

Barnatore Sara Farm 3  
02-3220-049

Barnatore Sara Farm 4  
02-3113-129

Barnatore Saraj Farm  
02-2057-069

Barnatore Stem  
02-3176-335

Barnatore Datel Farma Qendër  
075-265-564

## SHTIP

Barnatore Biolek  
032-391-777

Barnatore Dijana  
032-392-707

Barnatore Zdravje 1  
078 264 148

Barnatore Zdravje 2  
078 264 141

Barnatore Medifarm  
032-394-143

Barnatore Radolek  
032-380-190

## STRUGA

Barnatore Bela-Dona  
046-786-750

Barnatore Hamamelis  
046-702-706

## STRUGA F.VRANISHTA

Barnatore Hamamelis 2  
046-702-706

## STRUMICA

Barnatore Verbena  
034-551-031

Barnatore Zanina  
034-346-972

Barnatore Zanina 2  
079-273-700

Barnatore Panacea  
034-320-395

Barnatore Farmaka  
034-322-251

Barnatore Verbena 2  
034-550-519

## TETOVË

Barnatore Bami Kor Medika  
044 335 747

Barnatore Qytet Tetovë  
044-334-425

Barnatore Eliskir  
070-887-393

Barnatore Herba  
044-335-145

Barnatore Andol-G  
044-347-049

Barnatore Biofarm  
044-344-292

Barnatore Vital-Farm  
071-536-614

Barnatore Dushica Farm  
044-451-002

Barnatore Medika  
044-339-466

Barnatore Losiones Medika Farm 1

## TETOVË F. PIROK

Barnatore Sano Farm  
044-371-579

## TETOVË F. TEARÇË

Barnatore Herba Farm 2  
071-224-827

## BARNATORE MENA FARM

Barnatore Mena Farm  
078-415-079

## VEVÇAN

Barnatore Bela-Dona  
070-362-210

## VELES

Barnatore Ziva Farm 1  
043-235-121

Barnatore Ziva Farm 2  
043-251-005

Barnatore Ziva Farm 3  
043-230-121

Barnatore Ziva Farm 4  
043-225-255

Barnatore Ziva Farm 5  
078-371-585

Barnatore Magna Farm 2  
043-211-499

## VINICA

Barnatore Arka  
033-362-685

Barnatore Arka Nova  
033-364-685

ЗА ОДМОР БЕЗ ПРОБЛЕМ - НЕ ОДЕТЕ БЕЗ СИНОПЕН

# Synopen®



против АЛЕРГИСКИ РЕАКЦИИ НА КОЖА и КАСНУВАЊЕ ОД ИНСЕКТИ.  
со СМИРУВАЧКО и БРЗО ДЕЈСТВО (5-10 минути од примената).



ПЛИВА дооел Скопје, Никола Парапунов бб, Скопје тел/факс: 02 3062 702

MK/SYPN/19/0001

 PLIVA

Членка на групацијата Teva

ПРЕД УПОТРЕБА ВНИМАТЕЛНО ДА СЕ ПРОЧИТА УПАТСТВО!  
ЗА ИНДИКАЦИИТЕ, РИЗИКОТ ОД УПОТРЕБА И НЕСАКАНИТЕ ДЕЈСТВА НА ЛЕКОТ КОНСУЛТИРАЈТЕ СЕ СО ВАШИОТ ЛЕКАР ИЛИ ФАРМАЦЕВТ



NATURA  
THERAPY

Купи здравје  
од природата!

2+1 ПАКЕТ  
**1990** ден



1+1 ПАКЕТ  
**2490** ден



2+1 ПАКЕТ  
**1990** ден



[facebook.com  
naturatherapy.mk](https://facebook.com/naturatherapy.mk)

[instagram.com  
@naturatherapy.mk](https://instagram.com/@naturatherapy.mk)

070/230 720  
[www.naturatherapy.mk](http://www.naturatherapy.mk)